

NIËNDORI

REVISTË
LETRARE-ARTISTIKE, SHOQËRORE-POLITIKE

L. Shyq. Shkurtarim

590

1

1954

Çmimi: 1

NENDORI

REVISTË E PËRMUAJSHME
LETRARE — ARTISTIKE
SHOQËRORE — POLITIKE
(Viti I i botimit)

Nr. 1 JANAR 1954

ORGAN I LIDHJES SË SHKRIMTARËVE TË SHQIPËRISË
DHE I LIDHJES SË ARTISTËVE TE SHQIPËRISË


L E N D A

Për një ngritje të krijimtarisë letrare dhe artistike.
Venim i Këshillit të Ministrave mbi shpallje konkursi për Hymnin e R.P.SH.
Venim i Këshillit të Ministrave mbi shpallje konkursesh për nder të 10-ve-
trit të çlirimit.

KOÇË JAKOVA	Toka jonë (dramë)
RAI BRAHIMI	Një fletë e çkëputur (tregim)
SHAQIR PRIZRENDI	Nandori (vjershë)
MIZAFER XHAXHIU	Lenica (vjershë)
SEMAN VAQARI	Kangë djaloshare (vjershë)
	Dashnorja e rojes së kufinit (vjershë)
	Miqsija (vjershë)
KOV XOXA	Tre pleqtë dhe Mihali katër (tregim humoristik)

NGA LIRKA SOVJETIKE

PHAILL ISAKOVSKI ;	Fizarmonika vetmitare Përcjellje Dollija Ashtu siç ishte ti ke mbetë Natasha Na s'u shoqnuem E kush e kupton Lulëzoi kalina
------------------------------	--



PROZË SOVJETIKE

KOLLAJ TIHONOV	Zaptonjësi (tregim)
RDHYL KOSOVA	Kujtimi i pavdekshëm i Vlladimir Iliç Leninit
DON PANO	Filmi i madh «Skënderbeu»

BAKI KONGOLI
MUSTAFA KRANTJA

Sukses për artin tonë të ri
Folklorizëm dhe formë nacionale

KRITIKË E BIBLIOGRAFI

VEHBI BALA Një shprehje e re në poezinë tonë të re
MARK GURAKUQI «Këngët e para» – nga Vehbi Skënderi.

ALEKSANDËR XHUVANI Mbi pastërtin' e gjuhës

NGA KRITIKA SOVJETIKE

KOSTANTIN SIMONOV Problemet e zhvillimit të dramaturgjisë sovjetike

Përsëritje laureatëve të Çmimit «Stalin»

KRONIKË KULTURALE

U kthye në atdhe delegacioni ynë kultural që vizitoi Bashkimin Sovjetik — Mbledhja plenare e Lidhjes së Artistëve — Premiera «Nderi i familjes» në skenën e Teatrit Popullor — Skenaristi M. Papava takohet me njerzit e artit dhe të kulturës — Konferenca e ortografisë — Zbulimet arkeologjike të vitit 1953 — Letërsia jonë e re në botën e jashtme.

«Kultura» në botën kapitaliste.

Veprat letrare origjinale botuar gjatë vitit 1953

Për një ngritje të krijimtarisë letrare dhe artistike

Atdheu ynë ka hyrë në vitin e dhjetë të jetës së tij të lirë. Populli shqiptar, — punëtorë, fshatarë e intelektualë, — ka vënë të gjitha forcat që ta presë me duar plot dhjetvjetorin e lirisë së tij. Organit të ri të Lidhjes së Shkrimtarëve dhe të Lidhjes së Artistëve të Shqipërisë «Nëndori», që e fillon jetën e tij këtë vit të shënuar, i dalin përpara detyra të rëndësishme për të vënë në jetë mësimet e Partisë për zhvillimin e kulturës sonë të re, socialiste nga brendija dhe nacionale nga forma, për t'u bërë vatër për grumbullimin dhe aktivizimin e forcave krijuese të vëndit tonë.

Një vëmendje të veçantë do t'i kushtojë «Nëndori» zbulimit dhe edukimit të talenteve të reja, që do t'i japin gjallëri jetës kulturele të Republikës, që do të shtojnë e forcojnë rradhët e frontit letrar e artistik, që do të krijojnë brezin e ardhëshëm të ndërtuesve të kulturës socialiste.

«Nëndori» ka detyrën me luftue të gjitha të metat, gabimet dhe pengesat që dalin në rrugën e vështirë por fisnike të zhvillimit të letërsisë e të arteve, me rrahë në mënyrë parimore problemet teorike me karakter profesional e ideologjik, duke u bërë kështu një organ luftarak për një krijimtarinë letrare e artistike të ngritur nga ana ideo-artistike, të mbështetur në metodën e realizmit socialist.

«Nëndori», shtron si detyrë të vetën të ndriçojë dhe të ngrejë lart, duke u mbështetur në teorinë marksiste-leniniste, traditat kulturele dhe artistike të së kaluarës së lavdishme të popullit tonë, që e ka çarë rrugën e historisë me shpatë në dorë, që ka vazhduar të krijojë edhe në vitet më të rënda të robërisë kulturën e vet.

«Nëndori» do të bëhet tribuna nga ku të dëgohet zëri i shkrimtarëve dhe artistëve tanë për problemet e gjithanëshme të ndërtimit të bazave të socializmit, duke marrë kështu pjesë aktive në ndriçimin e politikës së brëndëshme dhe të jashtme të Republikës sonë Popullore. Sa më shumë bukë, sa më shumë kulturë për popullin, përpjekje të palodhëshme për ngritjen e nivelit të jetës së masave punonjëse. Miqësi e përjetëshme me Bashkimin e Madh Sovjetik, me Republikat motra të demokracisë popullore dhe me pupujt e tjerë, që luftojnë për forcimin e paqës, për liri, demokraci e socializëm. Demaskim i pamëshirëshëm i akteve të politikës dhe të ideologjisë së imperializmit dhe shërbëtorëve të tij.

Në revistën «Nëndori» duhet të pasqyrohet jeta kulturele e vëndit, ai lulëzim i kulturës që ka filluar në Republikën tonë me vendosjen e pushtetit popullor, nën udhëheqjen e kujdesin e Partisë dhe të Qeverisë. Në faqet e saj duhet të dalin forca e lulëzimi i kulturës në Bashkimin Sovjetik e në demokracitë popullore, përpjekjet e forcave progresive kulturele në vëndet e tjera dhe, njëkohësisht kalbësija dhe degjenerimi i „kulturës» në botën kapitaliste.

Në gjithë punën e saj revista «Nëndori» do të ketë parasysh eksperiencën e letërsisë dhe të artit sovjetik, që na ndriçojnë gjithmonë rrugën

dhe janë burim frymëzimi për shkrimtarët dhe artistët tanë. Revista duhet të kontribuojë për njohjen e letërsisë dhe artit sovjetik në masat e gjëra të lexuesve.

Viti 1954, viti i katërt i 5 vjeçarit tonë të parë, viti i përvjetorit të dhjetë të çlirimit të Atdheut, i ve përpara «Nëndorit» detyra të rëndësishme për edukimin e masave punonjëse me frymën e socializmit, i ve përpara detyrën e nxitjes së gjithanëshme të forcave letrare e artistike për të marrë pjesë në konkurset e shpallura me vendim të Këshillit të Ministrave dhe që na po i botojmë më poshtë. Vetë konkurset do të jenë një nxitje e madhe për krijime më të shumta e me cilësi më të lartë, për t'u hedhur me guxim në gjini të larta të krijimtarisë si romani, drama, poema, kantata, oratorio etj. ose për të zhvilluar gjini fare të reja për njerëzit tanë të letërsisë e të arteve si libreti për opera a balet, skenari për film artistik etj. Dhjetëvjetori i Atdheut duhet ta gjejë Republikën tonë me hymnin e saj të ri. Dhe detyra e krijimit të hymnit është një detyrë nderi për poetët dhe kompozitorët tanë.

Detyra të tilla i kanë shtruar organit të tyre, revistës letrare-artistike, shoqërore-politike «Nëndori» Komitetet Drejtuese të Lidhjes së Shkrimtarëve dhe të Lidhjes së Artistëve të Shqipërisë. Detyrat që i vihen revistës «Nëndori» janë të shumta e të vështira, kryerja si duhet e këtyre detyrave kërkon pjesëmarrjen e gjithë atyre që kanë për zemër lulëzimin e kulturës shqiptare, kërkon zgjimin e talenteve të reja e të panumërta që ka në gjinjtë e tij populli ynë, kërkon punë të vazhdueshme e të palodhëshme. Në punë, pra, shokë shkrimtarë dhe artistë, që ta bëjmë organin tonë çdo ditë më të denjë për barrën e rëndë e fisnike që i ka ngarkuar populli, në punë që në ditën e 10-vjetorit të lavdishëm të çlirimit të Atdheut të mund të themi se e kemi kryer me nder detyrën tonë, në punë, o shokë, përpara për një ngritje të krijimtarisë letrare e artistike!

VENDIM I KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË R. P. SH. MBI SHPALLJEN E KONKURSIT PËR HYMNIN E REPUBLIKËS POPULLORE TË SHQIPËRISË

Këshilli i Ministrave i Republikës Popullore të Shqipërisë në mbledhjen e datës 30/XII/1953, për nder të 10-vjetorit të lavdishëm të çlirimit të Shqipërisë, 29 Nëntor 1954,

VENDOSI:

- 1) Të shpallë konkursin për hymnin e Republikës Popullore të Shqipërisë.
- 2) Të shpërblejë fituesin e konkursit për tekstin e hymnit me 30.000 (tridhjetmijë) lekë dhe fituesin e konkur-

sit për muzikë me 40.000 (dyzetmijë) lekë.

3) Konkursesit veprat e tyre t'ia paraqesin «Komisionit të konkursit të 10-vjetorit të çlirimit të Shqipërisë» pranë Ministrisë s'Arësimit dhe Kulturës. Afati i paraqitjes së tekstit të jetë deri më datën 31-III-1954 dhe kompozicioni muzikor deri më 15 gusht 1954.

KRYETAR I KËSHILLIT TË MINISTRAVE
TË R.P.SH.

Enver Hoxha

VENDIM I KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË R. P. SH. MBI SHPALLJE KONKURSESH PËR NDER TË 10 VJETORIT TË ÇLIRIMIT

Këshilli i Ministrave të R.P.SH. në mbledhjen e tij të datës 30/XII/1953, pasi shqyrtoi propozimin e Ministrisë së Arësimit dhe Kulturës mbi shpallje konkursesh në fushën e letërsisë dhe arteve, me rastin e 10-vjetorit të lavdishëm të çlirimit të Shqipërisë 29 Nëntor 1954,

VENDOSI:

- 1) Ministria e Arësimit dhe Kulturës, Lidhja e Shkrimtarëve dhe ajo e Artistëve të shpallin konkurse në fushën e letërsisë dhe të arteve me rastin e 10-vjetorit të çlirimit të vendit dhe t'u japin çmime në të holla fituesve në konkurs në masën që caktohet në listat anekse të këtij vendimi.
- 2) Veprat të paraqiten duke filluar nga 1 Janari deri më 30 shtator 1954 duke patur si tematikë, dy nga periudhat më të lavdishme të historisë së popullit tonë: Luftën heroike nacionalçlirimtare dhe punën vigane të gjithanëshme për ndërtimin e bazave të socializmit.
- 3) Ministria e Arësimit dhe Kulturës, Lidhja e Shkrimtarëve dhe ajo e Artistëve të caktojnë juritë për shpalljen e

rezultateve të konkurseve më 29 nëntor 1954.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I KËSHILLIT TË MINISTRAVE
TË R.P.SH.
Enver Hoxha

LISTA ANEKSE E VENDIMIT

I. — KONKURSI PËR VEPRAT LETRARE:

1) Për romanet jepen 3 çmime:

Për çmimin e I-rë jepen lekë 75.000
» » » II-të » » 60.000
» » » III-të » » 40.000

2) Për pjesët teatrale:

a) Për pjesët me shumë akte jepen 3 çmime:

Për çmimin e I-rë jepen lekë 60.000
» » » II-të » » 40.000
» » » III-të » » 25.000

b) Për pjesët me një akt jepen 3 çmime:

Për çmimin e I-rë jepen lekë 15.000
» » » II-të » » 10.000
» » » III-të » » 7.000

3) Për tregimet e gjata jepen tre çmime:

Për çmimin e I-rë jepen lekë 40.000
» » II-të » » 30.000
» » III-të » » 20.000

4) Për tregimet e shkurtëra jepen tre çmime:

Për çmimin e I-rë jepen lekë 20.000
» » II-të » » 15.000
» » III-të » » 10.000

5) Për reportazhe letrare jepen tre çmime:

Për çmimin e I-rë jepen lekë 20.000
» » II-të » » 15.000
» » III-të » » 10.000

6) Për libret opere ose operete dhe për skenarë filmi artistik jepen nga tre çmime:

Për çdo çmim të I-rë jepen lekë 40.000
» » » » II-të » » 35.000
» » » » III-të » » 30.000

7) Për libret baletit dhe për skenar filmi dokumentar:

Për çdo çmim të I-rë jepen lekë 30.000
» » » » II-të » » 25.000
» » » » III-të » » 15.000

8) Për poema jepen tre çmime:

Për çmimin e I-rë jepen lekë 40.000
» » II-të » » 30.000
» » III-të » » 20.000

9) Për vëllime vjershash jepen tre çmime:

Për çmimin e I-rë jepen lekë 40.000
» » II-të » » 30.000
» » III-të » » 20.000

II. — KONKURS PËR VEPRAT E ARTEVE FIGURATIVE:

1) Për pikturën jepen tre çmime:

Për çmimin e I-rë jepen lekë 75.000
» » II-të » » 60.000
» » III-të » » 40.000

2) Për skulpturën jepen tre çmime:

Për çmimin e I-rë jepen lekë 75.000
» » II-të » » 60.000
» » III-të » » 40.000

3) Për karikaturë jepen tre çmime:

Për çmimin e I-rë jepen lekë 15.000
» » II-të » » 10.000
» » III-të » » 8.000

4) Për plakatit jepen tre çmime:

Për çmimin e I-rë jepen lekë 15.000
» » II-të » » 10.000
» » III-të » » 8.000

III. — KONKURS PËR VEPRAT MUZIKORE

1) Për këngë masash jepen tre çmime

Për çmimin e I-rë jepen lekë 10.000
» » II-të » » 8.000
» » III-të » » 5.000

2) Për tabllo muzikore jepen tre çmime:

Për çmimin e I-rë jepen lekë 20.000
» » II-të » » 15.000
» » III-të » » 10.000

3) Për kantatë dhe oratorio jepen tre çmime:

Për çmimin e I-rë jepen lekë 35.000
» » II-të » » 30.000
» » III-të » » 25.000

4) Për operetë jepen tre çmime:

Për çmimin e I-rë jepen lekë 40.000
» » II-të » » 30.000
» » III-të » » 20.000

Juritë për shpalljen e rezultateve të konkurseve më 29 Nëntor 1954

Në bazë të vendimit të Këshillit të Ministrave, Ministria e Arsimit e Kulturës, Lidhja e Shkrimtarëve dhe Lidhja e Artistëve të Shqipërisë caktojnë juritë e mëposhtme për shpalljen e

rezultateve të konkurseve në fushën e letërsisë e arteve me rastin e 10-vjetorit të lavdishëm të Shqipërisë 29 Nëntor 1954:

Për letërsi

Dhimitër Shuteriqi (Kryetar)
Gjovalin Luka
Javer Malo
Shevqet Musaraj
Llazar Siliqi
Sterjo Spasse
Misto Treska

Mustafa Krantja
Dhora Leka
Kostandin Trako

Për artet figurative

Foto Stamo (Kryetar)
Hysen Devolli
Kristina Hoshi
Odhise Paskali
Nexhmedin Zajmi

Për muzikë

Franjo Jakova (Kryetar)
Gaqo Avrazi

Të gjitha veprat për në konkurs duhet t'i dërgohen jurisë përkatëse pranë Ministrisë së Arsimit e Kulturës

FILMI I MADH «SKENDERBEU»

Një nga ngjarjet më me rëndësi në jetën kulturale të vendit për vitin 1953 është edhe filmi «Skënderbeu», realizuar sipas skenarit të M. Papavës nga regjizori S. Jutkeviç.

Me gjithë se për këtë vepër artistike është shkruar më shumë se për çdo vepër tjetër, prapë se prapë duhet të shkruhet akoma se ka plot material, të cilin nuk mund ta përmbledhësh në një artikull në mënyrë të plotë, për ta paraqitur denjësisht rëndësinë e madhe edukative të filmit si nga ana politike ashtu dhe nga ana artistike.

Rëndësi të madhe filmi me rregullisht nga fakti se gjer më sot asnjë film i madh artistik me karakter botnor, siç është filmi «Skënderbeu», nuk ka trajtuar subjekt shqiptar dhe e dyta se në këtë film kanë bashkëpunuar në një mënyrë të shkëlqyer edhe aktorët shqiptarë, aktorë të rinj, të lindur e të edukuar në republikën tonë, nën kujdesin e pushtetit popullor dhe të Partisë.

* * *

Skënderbeu është një nga figurat më popullore dhe më të dashura të popullit tonë. Për të kemi dëgjuar në familje nga pleqt e shtëpisë, në shkollë nga mësuesit, në shoqëri nga njerëz të ndryshëm. Me kalimin e kohës ky hero në mëndjen e njerëzve është idealizuar, ai është vigan me trup, ai ka një forcë të madhe fizike e shpirtërore, sa që jep urdhër dhe mbin një pyll i tërë ku fshihet ushtri e tij, simbas legjendës, ai është shpirt-madh dhe zemër-gjerë, ai është trim i paepur e mendje-mprehtë, ai është dragua siç e përshkruan Naimi:

«Në krah të djathtë, kur lindi
kishte një shenjë si shpatë,
gjithë botën e bindi

.....
ëndërr e ëma kish parë
sikur polli një dragua
kur ishte me të me barrë».

Jeta e Skënderbeut është gjithë luftra me Turqit. Plot 25 vjet ka luftuar, dhe në çdo betejë ka marrë pjesë vetë.

Të gjitha këto duhet të realizoheshin në një film dhe ne duhej t'i shikonim brënda dy orëve. Kuptohet se nuk është gjë e lehtë për të tre-guar ato më esenciale e jo pastaj hollësisht. Kështu e ka vetë natyra e filmit. Por regjizori S. Jutkeviç dhe skenaristi M. Papava, figurën e tij na e dhanë të plotë. Ata na e dhanë Skënderbeun hero-njeri, e jo hero fantastik.

Dashurinë që ka populli për Skënderbenë na e kanë dhënë për bukurin në skenën ku populli pret Skënderbeun të dëgjojë fjalët e tij, dhe në skenën kur Skënderbeu zgjedh ushtarët duke bërë mundjen e krahut del gjithë dashuria që ka ai për njerëzit. Ai është në mes tyre, qesh me ta, luan me ta, i do me zemër si vëlla, si baba e jo si princ i mesjetës. Një të tillë Skënderbeu ka populli në imagjinatën e tij. Kjo është një skenë emocionante.

Skenë që e ngre shumë lart figurën e Skënderbeut është ajo e pajtimit të gjakut. Ky trim me fletë që ka udhëhequr kaq e kaq beteja në Turqi e ka dalë fitimtar, ky kalorës i madh, princ nga dera e Kastriotëve, i ulet më gjunjë nënës Shqiptare, për të kërkuar faljen e gjakut. Por a nuk është kjo një gjetje e bukur e skenaristit dhe regjizorit për të ndriçuar figurën e Skënderbeut? A nuk shohim këtu një Skënderbeu të madh me shpirt, njeri, që për të zhdukur këtë zakon të tmerrshëm dhe çfarosës, marrjen e gjakut, ai s'e ka për gjë t'ulet, t'i bjerë më gjunjë Dafinës, veç të çduket hakmarrja në Shqipëri. Ja Skënderbeu burrë shteti, humanist, njeri i Rilindjes.

Bukur ka krijuar regjizori skenën kur malësorët zënë rrugën me trarë e me gurë, që i rrokullisin që nga lart. Kjo është tipike shqiptare. Populli ynë di të luftojë edhe me trarë e me gurë, me mjetet që ai i gjen pa vështirësi, por që lufton heroikisht dhe e shpartallon armikun. Por kryevepër e strategjisë së Skënderbeut është futja e turqve në kala, ku shqipot u hedhin lëngje të zjarra dhe i djegin turqit si miu. Në këtë skenë çdo spektator u kënaq, qeshi e brohoriti me gjithë shpirt, se kjo është lufta e tij, është urrejtja e tij që e ka edhe sot për armiqtë e atdheut.

Përse i përket mprehtësisë politike të Skënderbeut, ajo del qartë në marëdhëniet me të dërguarin e Venedikut në Shqipëri, Xhovani, i cili me intriga e dhelpëri kërkon që Republika e Venedikut të shtrijë sundimin e saj në Shqipëri.

Kështu e kanë ngritur figurën e Skënderbeut skenaristi Papava dhe regjizori Jutkeviç dhe e ka shprehur në interpretimin e tij të thellë aktori i madh Akakij Horava.

Rreth figurës së Skënderbeut veprojnë edhe persona të tjerë historikë si Lekë Dukagjini, Tanush Topija e princa të tjerë si edhe një serë personazhesh të krijuar si Pali, Gjini etj. Figurat e krijuara janë me të vërtetë tipike. Gjini, çobani i dhenve, njeri i thjeshtë por trim, është në çdo betejë. Ai është njeriu i popullit që nuk di të mburret, i hapët e i qeshur, që do familjen e bagëtin' e tij, që i vlon në gjak dashuria e madhe për atdhe. Pali bujk, vëlla qumështi i Mamicës, mposht çdo ndjenjë të vetën, dashurinë që ka për Mamicën, se kështu e do e mira e atdheut. Këto dy figura janë shumë njerëzore, si në krijimin e autorëve ashtu edhe në interpretimin e aktorëve B. Tjenin e N. Frashëri.

Interesante është skena e dasmës dhe njohja e Skënderbeut me Donikën. Këtu nuk është puna për faktin historik a e njohu Skënderbeu Donikën në dasmë dhe u dashurua me të, apo u martua me shkesëri. Kjo nuk ka rëndësi. Rëndësia është në interpretimin që i japin autorët asaj epoke. Ne dimë se 500 vjet të sundimit turk errësuan jetën e vendit, ata e kthyen kulturën shumë prapa, ata pothuaj e ndrydhën atë. Kjo prapëmbetje ka lënë gjurmët edhe në ditët tona, në perçen, që e mbanjë akoma disa gra në ndonjë qytet. Por ne kemi të dhëna të plota që vërtetojnë për një gjendje tjetër të gruas në vendin tonë. Malësorët, për shembëll, nuk e kanë mbuluar kurrë fytyrën. Unë s'mund ta parafytyroj, një labe apo lumjane me çarçaf. Gratë shqiptare dinë të punojnë për bukuri le-

shin, mëndafshin, ato qindisin pajën e tyre të nusërisë me duart e tyre dhe kostumet tona janë të pasura në ornamente, ato janë shumë artistike. Ne, në kostumet tona, gjejmë motivet e bukura të artit tonë popullor dhe këto kanë dalë nga dora e gruas sonë. Pra kanë shumë arsye autorët e filmit që të trajtojnë kështu këtë problem, sidomos në atë kohë ku ndikimi i qytetimit të Rilindjes ka hyrë në popullin tonë.

Filmi i Skënderbeut është një kryevepër filmi me ngjyra. Ngjyrat, si ato të njerëzve, kostumeve dhe ato të natyrës janë jashtëzakonisht natyrale, janë krejt të gjalla. Për këtë ka meritë të madhe kryeoperatori Andrikanis. Ai na ka dhënë të gjalla dhe me vlerë të lartë artistike peisazhin e Shqipërisë së bukur që kanë kënduar poetët.

Që në fillim na del madhështija e maleve tona, mbi malet e larta të Shqipërisë ngrihet si në fluturim titulli i filmit. Njeriu me një herë hyn në atmosferën e luftës së ashpër të një populli të vogël kundër një agresori të fortë e të egër. Dhe Shqipëria e bukur na del gjithëmonë përpara.

Filmit ia shton edhe më bukurinë muzika punuar nga kompozitori Çesk Zadeja dhe kompozitori sovjetik Sviridov. Muzika e popullit tonë është shumë e bukur. Motivët e saj, po të zhvillohen nga artistë, mund të shprehin gjithë botën e brendëshme të njeriut. Me bazë motivin e njohur «qenkan mbushun malet me borë» — na janë dhënë gjendjet shpirtërore që nga skenat lirike të natyrës, gjer te sulmi i kavalerisë luftarake e gjer te skenat lirike të natyrës, gjer te sulmi i kavalerisë luftarake e gjer te skena e vdekjes së Mamicës.

Ne artistët shqiptarë jemi krenarë për realizimin e këtij filmi. Ne aty gjejmë një shkollë të vërtetë ku mund të mësojmë shumë gjëra të dobishme dhe të nevojshme për krijimet tona. Për këtë ne falënderojmë me gjithë zemër pjesëmarrësit e filmit dhe i jemi mirënjohës Partisë sonë të Punës dhe qeverisë sonë, që, me politikën e tyre, krijuan mundësitë e miqësisë së popullit tonë me popujt e Bashkimit Sovjetik, miqësi dhe dashuri që shprehet në kujdesin e madh që tregojnë njerëzit sovjetikë, në ndihmën e tyre të madhe në të gjithë aktivitetin tonë shoqëror, si në fushën ekonomike ashtu dhe në atë të arteve dhe kulturës.

SUKSES PËR ARTIN TONË TË RI OPERA E PARË NË SKENËN SHQIPTARE

Në pragun e festës së madhe të nëndëvjeterit të çlirimit të Atdheut, dy ngjarje me rëndësi u shënuan në jetën tonë artistike e kulturele. Realizimi i shkëlqyer i filmit të madh artistik «Skënderbeu» dhe vënia në skenë për të parën herë në historinë e popullit tonë të operas «Rusallka» të kompozitorit klasik rus Aleksandër Sergejeviç Dargomirzhski. Përgatitjet e kësaj opere, që u filluan para një viti nga grupet e solistët e Filharmonisë Shqiptare, u ndoqën me vemendjen më të madhe jo vetëm nga njerëzit tanë të artit por nga mbarë populli shqiptar.

* * *

Aleksandër Sergejeviç Dargomirzhski është një nga kompozitorët më të shquar rusë në shekullin e XIX. Lëu në Tula më 2 Shkurt të vitit 1813 dhe vdiq më 5 Janar të vitit 1869 në Petersburg. Në punën e tij krijonjëse, Dargomirzhski ndoqi rrugën e Glinkës, themeltonjësit të muzikës klasike ruse, me të cilin u njoh në vitin 1833, duke u lidhur me një miqësi të ngushtë dhe të sinqertë që e vazhdoi për tërë jetën — i pajisur me një talent të madh, qysh në kohët e para të fëmijërisë Dargomirzhski merret me krijimtari muzikore duke kompozuar romanca, pjesë për piano, muzikë orkestrale etj. Krijimet e tij me vlerë, veç «Rusallkës», janë opera-balet «Triumfi i Vakhit», që u kompozua në vitin 1848 sipas poemës me të njëjtin titull të Pushkinit, «Esmeralda» me subjektin e romanit të Viktor Ygojt «Notre dame de Paris», kompozuar në vitin 1839; opera e fundit «Mysafiri prej guri» sipas dramës së Pushkinit e vepra të tjera orkestrale «Kozaku i vogël», «Shtriga», «Fantazi mbi tema finlandeze» etj. Në krijimin e muzikës së «Rusallkës», Dargomirzhskin e tërhoqi pjesa e poetit të madh Pushkin. Prallat popullore Ruse plot jetë, humor, mbrendi e humanizëm u ngritën në majën më të lartë të artit nga penda magjike e poetit më të madh të popullit rus, Pushkinit. Duke e lexuar këtë pjesë kaqë të bukur e njerëzore, Dargomirzhski iu vu punës së krijimit të muzikës qysh në vitin 1848 dhe e mbaroi atë në vitin 1855. Libretin e operës Dargomirzhski e hartoi vetë, duke i bërë disa ndryshime për efekte skenike e muzikore por në pjesën më të madhe i ndejti besnik tekstit të Pushkinit.

Nga të gjitha veprat e Dargomirzhskit, «Rusallka» zë vendin e parë dhe përfaqëson kulmin e gjenisë krijonjëse të kompozitorit jo vetëm nga pasuria e madhe e melodive, ariëve, pjesëve korale, orkestracionit plot ngjyra por për realizimin e thellë, për mbrendinë e saj, për ndjenjat e për vërtetësinë e madhe të tipizuarit e karaktereve të ndryshme të personazheve, të cilëve Dargomirzhski u ka përshtatë një muzikë të mrekullishme plot jetë e kuptim. «Rusallka» është, ashtu si e quajti kompozitori e kritik i çuar rus A.N. Serov, një nga operat më të pasura, një nga operat më muzikale në botë. E mbështetur në tekstin e përmbajtjen e veprës së Pushkinit, muzika e kësaj opere na paraqet një dramë të thjeshtë njerëzore, ku kompozitori shpreh në mënyrë gjeniale, dhimbjet e

dëshprimin e një vajze, që bie viktimë e dashurisë së saj të singërtë dhe mashtrohet nga Knjazi i vendit, tragjedinë e një babe plak, i cili humbet të vetmen vajzë që e ka si dritën e syve, episode të ndryshme shpirtnore, një ngjarje të vërtetë plot dhimbje, konflikte, urrejtje e kontradikta, ku personazhet kryesorë në rolet e tyre na paraqesin jetën e gjallë të popullit ashtu siç është.

Me gjithë që kanë kaluar afro 100 vjet nga dita që «Rusallka» u-çfaq për të parën herë në skenë, ajo nuk e ka humbur edhe sot freskinë e vlerën e saj të madhe artistike. Opera «Rusallka» është vazhdonjësjë e denjë e operave shumë të bukura «Ivan Susanin» dhe «Rusllani e Ludmilla» të të madhit Glinka. Ndërsa drejt gjysmës së dytë të shekullit të XIX, krijimtaria operistike pëson një rënie në Europën Perëndimore, në Rusi dalin vepra plot përmbajtje, me një pasuri të madhe muzikale. Operat e Dargomirzhskit janë një urë nëpër të cilën kalon krijimtaria e Glinkës në grupin e të Pestëve e më vonë në atë të Çajkovskit.

Merita e kompozitorëve të mëdhenj Rusë nuk qëndron vetëm në gjeninë krijonjëse, në teknikën e kulturën e tyre të gjërë muzikore, por në faktin se duke studjuar muzikën e popullit, jetën e vuajtjet e tij, zakonet e ndjenjat, shpirtin e gjërë të popullit Rus ata krijuan një muzikë të re, një muzikë realiste, e cila mbështetesh në pasurinë e madhe e të pashtershme të popullit.

* * *

Si i paraqit muzika personazhet e operas «Rusallka»? Ariet e kënduara nga Natasha sidomos në aktin e parë janë plot fraza melodike të thjeshta, me një muzikë plot singeritet njashtu si është i thjeshtë dhe i singërtë shpirti i Natashës e cila e dashuron me gjithë zemër Knjazin dhe nuk arrin të kuptojë Knjazin kur ai i thotë se s'mund të qëndrojë më me atë mbasi do të martohet me një vajzë tjetër të radhës së tij. Dhe muzika arrin kulmin kur ajo shprehet plot sarkazëm dhe urrejtje duke kënduar:

Knjazët s'na qenkan të lirë
Të marrin vajzën q'ata dashurojnë...
Por ata na qenkan të lirë
Me lotët tona, jetën ta gëzojnë.
I lirë është Knjazi për mjerime,
Që të na shkeli me përbuzje,
Që ne të na shkretojë!
Pastaj guxim Knjazet na kanë
Të flasin për detyra e Perendi!
Martesa qenka veç mes tyre e shënjtë,
Dhe nderi ynë s'paska asnjë vlerë.

Qysh në aktin e parë ku Natasha këndon arjen e saj të bukur «Ah kaluan ato kohëra» e deri në skenën kur ajo nga dëshprimi hidhet në lumë muzika vjen gjithëmonë në «crescendo». Në duetin me Knjazin, në tercetin, në këngët e saj me korin e fshatarëve, Dargomirzhski ka shkruar një muzikë plot pasione, ndjenja e dramacitet. Pjesëve të kënduara nga solistët e kori u përgjigjet me fraza të bukura orkestra.

Me ngjyra të theksuara e me një kuptim të thellë është shkrojtur aria e Natashës në aktin e dytë, ku ajo këndon jashtë skenës. Në pallatin e Knjazit është dasëm. Knjazi martohet. Bojarët i sjellin atij dhurata dhe Knjazi i uron të gjithë. Fillon festa me këngë, hidhen valle

sllave, valle cigane, po për një ças dëgjohe kënga e Natashës. Dargomirzhski e kthen këtë ambjent festiv përnjëherë në shqetësim. Paralajmërimi i dy batutave që egzekuton orkestra ndërton krejt muzikën. Të gjithë janë në ankth dhe pyesin se kush këndon. Tingujt e orkestrës, frazat korale, pyetjet e Knjazit e urdhnat që ep ai që të dëbohet mullisaj përshkruhen me një muzikë prekëse, plot dramaticitet e kontradikta. Muzika këtu ia arrin plotësisht qëllimit për të shprehë gjithë çka ndodh në skenë.

E bukur është aria e Natashës që ajo këndon në pallatin e Rusallkave nën ujë. Natasha, kur hidhet në Dnjepër, nuk mbytet por bëhet mbretëreshë e Rusallkave. Aty lind dhe vajzën e saj Rusaloçkën. Me anën e saj, ajo kërkon të marrë hakun e ta sjellë përsëri Knjazin pranë vehtes dhe, si e dërgon të bijën në breg të Dnjeprit që t'i mbushë mendjen Knjazit të kthehet, këndon arien e saj «Ah qysh nga dita», e cila arrin kulmin në frazat e fundit:

Hakmarrja shpirtin po ma djeg
O Knjaz krenar, i imi je.

Ndërsa Natasha është një vajzë e thjeshtë, e singërtë, që s'di se ç'është interesi në dashuri, që shpirti i saj është i kulluar si ujët e Dnjeprit dhe i kthjellët si drita e diellit, mullisi, ati i saj, paraqitet njeri trashanik që lakmon paranë dhe kërkon ta bindë të bijën të martohet me Knjazin. Ariet e mullisit janë plot humor. Dargomirzhski, me anën e muzikës, e tipizon shumë mirë figurën e mullisit. Aria e mullisit në aktin e parë është një nga faqet më të bukura muzikale të operas. Ndërsa, në fillim, ay e qorton të bijën pse sillet me kaqë sentiment me Knjazin, kur e sheh se ajo hidhet në lumë, tronditet thellë dhe çmëndet. Takimi i tij me Knjazin në pyll është një nga skenat më prekëse të operas. «Unë dua që tingujt të shprehin drejt për së drejti kuptimin e fjalës, unë dua të vërtetën» shkruante Dargomirzhski. Prandaj jo vetëm në ariet, në këngët solo, në duetet, tercetet, pjesët orkestrale, por edhe në pjesët recitative, melodija e shoqërimit të orkestrës përputhet thellësisht me kuptimin e fjalëve.

Prekës është dueti i mullisit me Knjazin në aktin e tretë dhe kënga kur ay i lutet gjahtarëve që t'i thonë Knjazit t'i kthejë vajzën.

Aria e mullisit e koralet e fshatarëve në aktin e parë, këngët gazmore të Ollgës në aktin e tretë, paraqiten me ngjyrat e gjalla e intonacionet e këngëve popullore ruse. «**Sa më tepër studjoj elementet popullore ruse, — shkruanet Dargomirzhski — aq më shumë habitem nga pasuria e ndryshmëria e tyre.**»

Nga ariet më të bukura të Knjazit është padyshim kavatina, që ay e këndon në tabllonë e dytë të aktit të tretë. Kavatina është shkrojtur në mënyrë gjeniale nga Dargomirzhski, ajo është plot poezi e humanizëm. Kjo kavatinë është, padyshim, një nga krijimet më të bukura në muzikën e operas «Rusallka».

Knjazit nuk i ep lumturi martesa me knjaginën, atë e bren ndër-gjegjia dhe kujton ditët e lumtura që kaloi për një vit të tërë me Natashën. Ay largohet nga pallati në mëngjez herët dhe kthehet vonë në mbremje në shtëpi. I penduar thellë për krimin që ka bërë, ay, pa dashur, kthehet shpesh pranë mullirit tani të shkatërruar. I kujtohen ditët e bukura që kalonte me Natashën, shëtitjet në fushat e brigjet e Dnjeprit e orët që kalonte së bashku me të pa ndonjë trazim dhe është i dëshpëruar se tani, pas dymbëdhjetë vjetve, ajo kohë nuk do të kthehet më. Frazat melodike plot poezi, herë të qeta e herë të vrullshme, paraqesin me vërtetësi gjithë gjendjen shpirtnore të Knjazit.

Plot shprehje është shkrojtur aria e Knjaginës, që këndohet nga ajo në tabllonë e parë të aktit të tretë. Me anë të muzikës, kompozitori e ka shprehë me vërtetësi dëshpërimin që ndjen Knjagina, mbasi nuk gjen më lumturinë e parë, nuk gëzon më përkëdheljet e buzagazin e Knjazit si më parë, kur ishte e fejuar. Ajo ndien tani se shpresat po i ikin nga Knjazi dhe e tmerron dyshimi. Me një realizëm të math është shkrojtur muzika në skenën e Knjaginës me Ollgën, në tabllonë e parë të aktit të tretë. Pas aries së Knjaginës paraqitet në skenë Ollga, shoqe besnike e saj, e cila këndon dy fraza muzikore të thjeshta e gazmore ashtu si është tipi i asaj vetë. Ndërsa Ollga këndon këtë muzikë të lehtë e gazmore, një frazë e vetme e orkestrës e ndryshon krejt ambientin. Muzika bëhet më tragjike e çqetësonjëse, ashtu siç është gjëndja shpirtnore e Knjaginës. Nuk ka çast shpirtnor gjatë zhvillimit të operas, ku muzika të mos paraqesë realitetin.

Jo vetëm muzikën e solistëve, që interpretojnë personazhet e operas, por dhe korët janë shkrojtur me një art të përsosur. Si këngëtor i mirë e dirigjent i përsosur koresh Dargomirzhski ka shkrojtur pjesë të bukura korale plot ndjenja e shprehje të sinqerta.

Sa bukur tingëllon harmonia e korit në aktin e parë, kori i bojarëve me titull «Ti rrofsh o Knjaz» në aktin e dytë, këngët e dasmës e sidomos kori i Rusallkave në tabllonë e dytë të aktit të tretë etj.

Përpara se të hapët supari; orkestra ekzekuton uverturën. Për disa minuta rrjesht njeriu dëgjon një muzikë, ku sintetizohen momente të ndryshme e motive e fraza muzikore të cilat e çojnë fantazinë e dëgjovnjësit në krejt ngjarjen që do të zhvillohet më vonë në skenë. Herë me fraza të ngadalshme e lirike dhe herë me pasazhe të ngutëshme, paraqitet krejt përmbledhja e kuptimit muzikor të operas. Mendimet muzikore janë shprehë me modulacione të ndryshme, që janë qëndisur e ndërtuar me një art të stërhollë nga Dargomirzhski.

* * *

Masat punonjëse të kryeqytetit, spektatorët e ardhur nga qarqet e tjerë, po e ndjekin me vemendje e interes të madh çfaqjen e kësaj opere të mrekullishme. Gjatë intervaleve bëhen shumë komente. Të gjithë soditin artistët tanë të rinj, ansamblin e korit, atë të orkestrës dhe të baletit, skenografët e puntorët e skenës e gjithë punonjësit e tjerë.

Në dhjetor të vitit 1952 erdhi në vendin tonë, i dërguar nga Qeveria e Bashkimit Sovjetik, pedagogu i shquar i zërit dekan i konservatorit «Pjetër Pliç Çajkovski», të Moskës, Konstandin Nikollajevič Rushev. Nën udhëheqjen e tij, solistët tanë të Filarmonisë ia filluan punës me zell për të përvetësuar, si nga ana vokale ashtu edhe nga ana e kuptimit të rroleve, pjesët e tyre. Ndarja e personazheve u bë me kohë. Nga impossitimi i mirë i zërit, nga puna sistematike e shkencore, që bëri pedagogu Kostandin Rushev, artistët tanë mundën t'ia dalin punës me sukses.

Një punë të mirë e sistematike bëjnë dhe koristët e Filarmonisë nën udhëheqjen e dirigjentit Kostandin Trako. Si studjuan me zell brendinë e kuptimit e operas, tipat e karakteret e ndryshme të personazheve, që do të paraqitnin në skenë, ata e përgatitën shumë mirë anën muzikale të pjesëve korale të operas. Orkestra, megjithëse e vogël në numur, ia arriti për bukuri përvetësimin të teknikës orkestrale të partiturës dhe mundi t'i hyjë thellë interpretimit të muzikës së Rusallkës. Në këtë punë, ata përfituan mjaft nga këshillat e udhëzimet e dirigjentit të tyre Mustafa Krantja. Një punë e mirë u bë edhe nga pjestarët e baletit nën

udhëheqjen e pedagoges sovjetike Tatjana Rusheva e më vonë, me largimin e saj, nën udhëheqjen e balet-maestrit Panajot Kanaçi.

Soprano Jorgjia Truja e paraqiti mirë rolin e Natashës. Në skenën e saj me Knjazin, në aktin e parë, si nga ana muzikore ashtu edhe nga ana interpretative ajo e paraqiti mirë rolin e një vajze të thjeshtë, naive dhe pa të keq, që dashuron me sinqeritetin më të madh. Si në duetin me Knjazin, në dialloget e saj me të jatin, mullisin, në skenën kur hidhet në lumë, ajo u paraqit e natyrshme. Ajo e këndoi bukur dhe me sentiment arien «Ah kaluan ato kohra» në aktin e parë, arien prapa skenës në aktin e dytë dhe arien e fundit në pallatin e Rusallkave nën ujë. Gjatë përgatitjes së rolit të Natashës e më vonë të Rusallkës ajo ka bërë hapa përpara në punën e saj profesionale.

Shumë mirë e paraqet baritoni Hysen Pellingu rolin e mullisit. Arien e mullisit, në fillim të aktit të parë, ai e këndon me gjallëri e sentiment. Frazat muzikore i nxjerr me ritëm të theksuem, me shprehje e muzikalitet. Shumë bukur ay luan në aktin e tretë kur është çmëndur. Dueti i tij me Knjazin në këtë akt është prekës. Ai ia arrin të paraqesë rolin e tij jo vetëm nga ana muzikale por edhe si artist i mirë i skenës. Publiku e duartrokit baritonin Hysen Pellingu në çdo çfaqje për paraqitjen e mirë e me vërtetësi të rolit të tij.

Tenori Zihni Berati e paraqit mirë rolin e Knjazit. Në aktin e parë me Natashën, ai shpreh mirë gjëndjen e tij të mbrendëshme, kur do të ndahet. Po ashtu ai luan dhe në aktin e dytë në skenën e martesës; sukses të madh arrin në interpretimin e «Kavatinës» së Knjazit, në tabllonë e dytë të aktit të tretë, që është pjesa më e rëndësishme e rolit të tij. Me një zë të ëmbël e plot shprehje e ndjenja, ai interpreton muzikën e ëmbël e plot ngrohtësi të kësaj «kavatine» të shkrojtur nga Dargomirzhski me një art të përsosur. Si nga ana muzikale ashtu edhe nga ana interpretative, Zihni Berati e shpreh mirë brengën e pendimin që ka në zemër, kur kujton, me anën e kësaj arjeje, çastet e bukura e të lumtura që kaloi para dymbëdhjetë vjetëve me Natashën. Ai është në rol kur paraqet dëshpërimin e tij, kur sheh mullinë të shkatërruar, dhe çdo gjë që tani ka ndryshuar.

Prekëse është skena kur në tabllonë e dytë të aktit të tretë, ai takon mullisin të çmëndur, që rron si bishë e egër në një gjëndje të mjeruar dhe dhimbjen e mëshirën e paraqet me vërtetësi e muzikalitet. Ai luan mirë gjithashtu në skenën kur takohet për herë të parë me Rusalloqkën, nga e cila merr vesh se Natasha nuk ka vdekur por është gjallë dhe është bërë mbretëreshë e Rusallkave në pallatin madhështor të Dnjeprit nën ujë. Tenori Zihni Berati është një element me talent dhe po të punojë me zell në të ardhmen do të mund të paraqesë edhe role operash të tjera në skenë, duke përvetësuar sa më mirë teknikën e artin e Bel-Cantos.

Soprano Gjyze Kosturi, në arien e saj në tabllonë e parë të aktit të tretë, e shpreh mirë brengën e idhnimin që ka në zemër. Qysh në aktin e dytë, ajo e paraqit rolin e një femre aristokrate, shumë delikate e të pafat në martesën e saj me Knjazin. Ajo këndon mirë arien me kor në skenën e dasmës në aktin e dytë. Po ashtu edhe në takimin e saj me Knjazin në aktin e katërt ajo është brenda në rol si nga ana muzikale ashtu dhe nga ana interpretative.

Shumë e natyrshme e me muzikalitet të madh paraqitet në skenë soprano Marija Kraja në rolin Ollgës, shoqes besnike të Knjaginës. Teknika e saj e mirë në bel-canto, përvehtësimi i mirë i rolit nga ana e lëvizjeve dhe e shprehjeve e bëjnë atë të jetë një nga personazhet më sim-

patike në skenë. Kënga e saj plot humor, thjeshtësi e gëzim tërheq ve mendjen e dashurinë e dëgjonjësve.

Simpatik paraqitet në skenë baritoni Haxhi Tafaj në rolin e Shkezit. Ai ka studjuar me zell rolin e tij e në aktin e dytë, në martesën e Knjazit, paraqitet një shkez simpatik që sundon skenën. Dhe nga ana vokale baritoni Haxhi Tafaj ka ecë përpara.

Një punë të madhe kanë bërë pjestarët e korit të Filarmonisë, të cilët, nën udhëheqjen e kompozitorit Kostandin Trako, arritën të përvetësojnë mirë pjesët korale të operas duke i hyrë thellë kuptimit muzikal e psikologjik të roleve të tyre. Kompozitori Trako ka bërë një punë serioze në përgatitjen e korit. Këtë e vërteton suksesi që ka korrur kori në çfaqjet e deritanishme.

Meriton të shënohet puna e zellshme që kanë bërë pjestarët e orkestrës nën udhëheqjen e mësimit e dirigjentit M. Krantja. Me gjithë se e vogël në numur, orkestra e Filarmonisë ekzekutoi mirë muzikën e operas, shoqëroi me kuptim solet, duetet, tercetet, koralet e recitativet. Me realizimin e mirë të operas si kolektivi i korit ashtu dhe ai i orkestrës kanë shukur përpara e në të ardhmen ata do të mund të luajnë edhe opera të tjera në skenën tonë.

Porsa hapet skena paraqitet një tablo e bukur e brigjeve të lumit Dnjepër. Afër mullirit qëndron hije-rëndë një rrap, i cili, me pamjen e tij, paralajmëron dashurinë fatkeqe të Natashës e fundin e saj tragjik. Këtu çdo gjë është pikturuar sipas kërkesave muzikale të operas. Piktori Hysen Devolli ia ka arritë punës me sukses t'i paraqesë dekoret e përshatshme e plot kuptim në këtë skenë. Në aktin e dytë paraqitet lluksi i pallatit të knjazit, shandanat e mëdhenj e krejt ambienti i dasmës ruse. Po ashtu edhe akti i tretë i dhomës së knjaginës edhe akti i katërt i pallatit të Rusallkave nën ujë, paraqiten me kuptim e të lidhura ngushtë me brendinë e përmbatjen e operas.

Në suksesin e kësaj opere determinoi puna e palodhshme e plot durim e regjizorit sovjetik Ilia Jakovleviç Azhotkin. Ardhja e tij në Shqipëri, në pranverën e vitit të kaluar, gëzoi pamasë punonjësit e Filarmonisë sonë. Regjizori sovjetik Azhotkin punoi imtësisht me gjithë artistët e ansamblet e Filarmonisë duke bërë një punë shkencore e pedagogjike për kuptimin e interpretimin e mirë të roleve nga ana e artistëve tonë. Në çdo lëvizje skene e në çdo kuadër, ku paraqiten masa njerëzish, në çdo shprehje gëzimi, dhimbjeje, urrejtjeje, hakmarrje e emocione të tjera shpirtnore, që zhvillohen prej fillimit deri në fund të operas, është dora e regjizorit Azhotkin. Puna e tij si regjizor për realizimin e vënien në skenë të operas «Rusallka» ka qënë e vështirë edhe sepse artistët e kolektivat tona të Filarmonisë merrnin pjesë për herë të parë në çfaqjen e një opere. Për ata që e kanë parë gjer tani operan «Rusallka», sidomos për miqtë tanë të huaj që banojnë në Tiranë, përshtypja është kaq e mirë sikur të mos ishte kjo opera e parë që çfaqesh në vendin tonë.

Gjithë kjo punë e madhe nga ana interpretative i takon vullnetit të madh e mjeshtrisë së lartë të regjizorit Ilia Azhotkin.

I vështirë ka qënë bashkimi e koordinimi i grupeve dhe i solistëve bashkë me orkestrën. Opera është një kompozicion muzikal tepër i ndërlikuar dhe i vështirë për t'u realizuar, ku personat kryesorë e të dytë, masat e njerëzve, lëvizjet, fjalët, ndjenjat e dialloget çfaqen me anë të muzikës. Çdo individ ose ansambël duhet të lëvizë e të këndojë në skenë me ritëm. Një devijim sado i vogël prish krejt çfaqjen

Kostumet e fshatarëve në aktin e parë, të bojarëve në aktin e dytë,

të Rusallkave në aktin e tretë dhe të katërt kanë qënë të pasura dhe variante. Shumë i bukur është kostumi i knjaginës, ai i Rusallkës mbretëreshë dhe i Knjazit. Të gjitha këto i punoi me art dekoratorja e kostumeve Angje Noga sipas skicave të studjuara nga piktori Hysen Devolli.

Pjestarët e baletit luajtën mirë rolet e tyre. Vallja ruse dhe ajo cigane në aktin e dytë dhe vallja e Rusallkave në aktin e katërt, në pallatin nën ujë, u kërcyen mirë. Vlen të shënohet sidomos vallja e Rusallkave në aktin e katërt ku pjestarët e baletit kërcyen për herë të parë me majat e gishtave me puanti. Nën udhëheqjen e pedagoges Tatiana Rusheva e të balet-maestrit Panajot Kanaçi, ato arritën të përvetësojnë mire vallet e pjesët e baletit të operas.

* * *

Çfaqjet e operas «Rusallka» po korrin sukses sa herë që epen. Një e më të kryesore, jo vetëm për artistët e operas por edhe për ata të Teatrit e të Estradës, është se fuqitë e aftësitë e tyre i përqëndrojnë kur apin premierën. Një gjë e tillë ka ndodhë edhe me çfaqjet koreografike «Shatrivani i Bahçisarajt» dhe «Esmeralda» që kanë ndryshim të madh nga ana e kualitetit me çfaqjen e premierës. Kjo gjë rjedh, sigurisht, sepse nuk punohet me ngulm për t'i hyrë sa më thellë rolit që interpretojnë. Në vend që çfaqjet e tjera pas premierës të vinë duke u përmirësuar, si përfundim i përsëritjes dhe i përmirësimit të çfaqjes, ato bien nga ndonjë herë edhe shumë. Këtë gjë duhet ta kenë vath në vesh të gjithë artistët tanë. Çështja e ritmit dhe e intonacionit është akoma problematike si për artistët këngëtorë ashtu edhe për ansamblet e korit, orkestrës e baletit. Vallja cigane në aktin e dytë nuk shkon sa duhet me ritëm. Trokitjet e dajreve (defeve), lëvizjet e përplasjet e këmbëve, nuk janë me të njëjtin takt me orkestrën. Gjatë çfaqjeve të fundit janë vënë re atake të gabuara që e lenë dirigjentin në një gjëndje të vështirë, hyrje para kohës ose jashtë ose dy a tri takte përpara. Në arjet e knjazit, knjaginës e Natashës janë vënë re stornatura të palejuara dhe ritme jo të shëndoshë e të prerë. Orkestra me gjithë që e zotëron mirë muzikën, në disa çfaqje është paraqitur pa ekuilibër sidomos në uverturën e operas.

Duetet, tercetet e rolet e tjera në vend që të jenë në plan të parë mbyten nga kori e nga orkestra. Kënga e Ollgës në aktin e dytë nuk del në plan të parë. Këtë gjë duhet ta shikojë mirë dirigjenti, ta kontrollojë dhe kur është puna për një solo, duet ose tercet, që shoqërohet nga kori dhe orkestra, këto të fundit të këndojnë e të luajnë ma «piano» në mënyrë që të dalë kjartë çdo frazë, këngë apo arie.

Diletante paraqitet në opera çështja e teknikës së skenës dhe e dritave. Drejtorinë e udhëheqjen artistike të Filarmonisë duhet ta çqetësojë shumë sigurimi i kuadrit të mjaftushëm kompetent si dhe paisja e skenës me mjetet teknike të nevojshme, pa të cilat do të bjerë vazhdimisht kualiteti i çfaqjeve. Teknikët e puntorët e skenës të përfitojnë sa më shumë nga këshillat e sugjerimet e regjizorit Ilia Azhotkin.

Dedë Nika e Spiro Godella kanë punuar me zell për ta paraqitë operan sa më mirë nga ana e teknikës në skenë. Ata, në të ardhmen, duhet të shtojnë dhe më tepër aftësitë e tyre për të kapërxyer gjithë pengesat e vështirësitë në një skenë të vogël siç është kjo e sotmja, në mënyrë që të kenë praktikën e duhur në skenën e madhe të ardhshme të Teatrit tonë Nacional.

* * *

Realizimi i operas «Rusallka» në skenën tonë ka qënë një shkollë e madhe për të gjithë solistët e pjestarët e tjerë të kolektivave të Filarmonisë.

nisë. Me këtë rast, ata studjuan thellësisht gjithë elementët kryesorë e te dytë që përbëjnë operan në tërësi. Mësuan se si ta lidhin muzikën me shprehjet e brendëshme shpirtnore, kuptuan nga mjeshtria e aktorit duke i studjuar nga ana psikologjike rolet e tyre, e lidhën tekstin me shprehjen muzikore e me paraqitjen e rolit të tyre me anë të lëvizjes në skenë e shumë të tjera. Puna e palodhëshme e regjizorit dhe e dirigjentëve i bëri artistët tanë të kuptojnë mirë detyrën e tyre në çfaqjen e operas.

Opera, thotë kompozitori i çqar rus Çajkovski, ka mundësi të ushtrorë një ndikese të madhe mbi ndjenjat muzikale të masave. Vetëm opera ju sjell juve njerinë më afër dhe ju a bën pronë të përgjithshme jo vetëm të disa retheve të vegjël, por, në rrethana të favorshme, të popullit mbarë. Nga këto fjalë të Çajkovskit mbi operan del rëndësia e madhe edukative që ka ajo për edukimin e masave. Prandaj gjithë artistëve, kolektivave të Filarmonisë, u dhalin tani detyra të reja në përvetësimin e teknikës, në ngritjen e tyre ideo-profesionale dhe në përpjekjet e parreshtura për ta përvehtësuar sa më mirë rolin e tyre. Këngëtorët tanë duhet të përdorin me masë dhe urtësi organet vokale, të bëjnë një regjim të mirë dhe t'i largohen çdo sforçimi. Me ardhjen e pedagoges sovjetike Njina Konstantinovna Kuklina, ata do të përfitojnë mjaft në këtë drejtim.

Realizimi me sukses i operas «Rusallka» hap perspektiva për çfaqje të tjera operash në skenën tonë. Me pjekurinë dhe përvojën që fituan grupet e solistët e Filarmonisë gjatë përgatitjeve të «Rusallkës», ata do të jenë në gjendje që, në t'ardhmen, të na japin opera të tjera me vlerë.

Kompozitori i shquar Gjeorgjian Mshvelidze, në takimin që pati me delegacionin kultural shqiptar në shkurtin e vitit 1951, i këshilloi kompozitorët, shkrimtarët e piktorët shqiptarë, që mernin pjesë në atë takim, t'i viheshin punës për krijimin e një opere nacionale, ose të një pjesë muzikore me personazhe. Një punë e mirë kolegjiale midis poetëve e kompozitorëve do të sillte një përfundim shumë të mirë tha shoku Mshvelidze. Eksperienca jonë e deritanishme na e vërteton më së mirë se sa përfitime do të ketë bashkëpunimi i ngushtë i letrarëve me muzikantët. Si shembull mund të sjellim bashkëpunimin e Llazar Siliqit me Prenk Jakovës me Kristo Konon në operetën «Agimi», atë të Andrea Varfit me Kostandin Trakon e Dhora Lekën në oratorin «Partia» e në kantatën «Shqipëri, Atdhe i lavdishëm». Suksesi i operas «Rusallka» dhe krijimet muzikore të vitit 1953 vënë përpara shkrimtarëve e kompozitorëve detyra të reja. Për vetë konditat e gjendjen tonë të sotme, është më se i domosdoshëm një bashkëpunim më i ngushtë ndërmjet shkrimtarëve e kompozitorëve për të pasë në të ardhmen operan tonë të parë nacionale. Duke parë vazhdimisht operan «Rusallka», duke studjuar librete operash të tjera, shkrimtarët tanë do të jenë në gjendje fare mirë të hartojnë librete shumë të mirë për opera, opereta e pjesë të ndryshme muzikore me personazhe.

Viti 1954, vit në të cilin gjithë populli ynë do të festojë me gëzim, harë e me duar plot 10-vjetorin e çlirimit të vendit nga pushtonjësit fashistë e tradhëtarët e vendit, ne do të na gjejë me krijime të reja letrare e muzikore. Brenda një kohe fare të shkurtër populli ynë ka korrur suksese të njëpasnjëshme në lëmin ekonomik, politik e kultural. Nën udhëheqjen e kujdesin e madh të Partisë e të Pushtetit Popullor dhe me ndihmën e çmuar të përvojës sovjetike, arti e kultura në vendin tonë ecin përpara drejt fitoresh të reja, një nga të cilat qe edhe realizimi i operas së parë në skenën shqiptare.

FOLKLORIZËM DHE FORMË NACIONALE

Në hovin gjithënjë më të madh që kanë marrë në vendin tonë artet, kompozitorëve shqiptarë u bije barra e përpjekjeve sa më serioze për të krijuar vepra të tilla muzikore, që të jenë të denja me pasqyrue vrrullin ngadhënjimtar të masave tona punonjëse drejt ndërtimit të socializmit. Gjatë këtyre 9 vjetëve të çlirimit, krijimtarija muzikore tek ne ka bërë përparime, që në të kaluarën as që mund të mendoheshin. Puntori ynë në uzinë, ishatari në fushat pjellore e në kooperativë, nxënësi në shkollë, ushtari në kufi, etj. i këndojnë të lirë punës së tyre e të ardhmes së lumtur t'atdheut tonë të dashur. Ata kanë këngët e tyre, jo me kanconeta t'importuara nga jashtë për të prishur shijen për art të vërtetë të njerëzve tanë, por këngë të lidhura dhe të frymëzuara në vrullin e punës së tyre.

Krahas me këngët, njerëzit tanë të krijimtarisë janë hedhë edhe në forma të tjera edhe më të gjëra muzikore. Në këtë punë të vështirë ata kanë patur dhe kanë gjithënjë kujdesin e Partisë së Punës dhe të Qeverisë.

Çfaqja me sukses e operas, për të parën herë në vendin tonë, është për ta një ndihmë jashtëzakonisht e madhe. Si një nga veprat më të mira të artit realist rus të shekullit XIX-të, ajo u mëson atyre artin e krijimit të figurave e të personazheve simbas karakterit dhe psikikës së tyre, ndërtimin organik të një forme të tillë, problemin e konflikteve në kuadrin e dramaturgjisë muzikore e shumë e shumë gjëra të tjera.

Porse në këtë punë të vështirë të krijimtarisë, drejt rrugës për të shkruar sidomos në formë nacionale, kompozitori bije shpesh herë në pozita të thjeshta folklorizmi. Arësytet e këtij fenomeni që rëndon jo pak në prodhimet tona të para, edhe në të fundit bile, nuk janë të thjeshta.

Por ajo që e përcakton në radhë të parë këtë mungesë është egzistenca e një koncepti të gabuar jo të plotë dhe të drejtë për sa i përket anës konkrete të formës nacionale në muzikë. Duke e ndarë këtë edhe më tutje mund të themi kështu;

a) Njohje dhe studim i pamjaftueshëm, jo i thellë i materialit popullor, që shërben si bazë e punës drejt formës nacionale domethënë **folklori**.

b) Përpjekje të pamjaftueshme ideo-profesionale dhe artistike, të domosdoshme për të konkretizuar drejt e realisht parimet që përmban metoda e realizmit socialist në krijimtari.

c) Me këtë lidhet mungesa e konflikteve dhe e dramaturgjisë muzikore, që e bën veprën të pa jetë.

Nga puna e gjertanishme, kompozitorët e gjithë njerëzit e arteve tek ne kanë përgatitje përsa i përket anës parimore të kësaj çështje. Kujdesi që tregoi qysh në fillim Partija për të drejtuar punën e tyre në bazë të metodës së realizmit socialist, është baza e të gjitha anëve pozitive që ekzistojnë në punimet tona. Sot është e kjartë për të gjithë se vetëm uniteti më i ngushtë ndërmjet përmbajtjes socialiste dhe formës nacionale, ndërmjet idesë dhe realizimit artistik, është kyçi dhe baza e sukseseve të çdo veprimtarije në krijim.

Për të gjithë ne është e kjartë se muzika, si gjithë artet e tjera, nuk mund të zhvillohet jashtë konditave historiko-shoqërore, jashtë interesave më të larta të atdheut tonë. Në këtë drejtim, rruga jonë është e ndritshme dhe shumë fisnike: është rruga e traditave më të shkëlqyera botërore në fushën e krijimtarisë muzikore, është rruga që na kanë hapur Bethoven, Glinka, Çaikovski, Musorgski, Smetana, Verdi etj, është rruga drejt së cilës na udhëheq përvoja e artit më të përparuar në botë, e artit sovjetik.

Ne po ngrehim një art të ri mbi pozita shumë të shëndosha, një art të tillë, që t'i flasë njeriut tonë të ri drejt e sinqerisht, me vërtetësinë më të madhe, me konditat e zhvillimit të jetës sonë, të tillë, që të pasqyrojë luftën e masave tona për një jetë më të mirë.

Por në punën krijonjëse të gjer tanishme kemi edhe të meta. Në vendimet e Byrosë politike të partisë sonë mbi artet flitet për pamjaftueshmëri fuqije shprehëse, për karakter të zbehtë edhe në literaturën e sotme muzikale. Kryesisht sepse kompozitorët tanë e gjithë njerëzit e arteve në praktikë nuk janë ende në lartësinë e duhur për të konkretizuar në punimet e tyre, në mënyrën më të plotë, gjithçka kërkon metoda e realizmit socialist. Veç këngëve të ndryshme të masave, një pjesë e konsiderueshme e të cilave është në gjëndje t'u përgjigjet kërkesave të duhura, një pjesë nga format më të gjera tonat vuajnë nga një varfëri inspiracioni, shprehje të drejtë, për formë muzikale, organizimet, lindje logjike e tjera. Të gjitha këto të meta e bëjnë veprën të humbasë karakterin emocionant të saj, jetën e saj; ajo nuk i imponohet veshit e ndjenjave të dëgjonjësve tanë me vërtetësinë e duhur.

Ndër të metat që kanë qenë mjaft të theksuara gjer në kohët e fundit e që mbetet gjithënjë problem për t'u zgjidhur nga gjithë kompozitorët tanë është edhe **të rënë për hir të formës nacionale në pozita folklorizmi.**

Kompozitori (më tepër në periudhat më të para të krijimtarisë së vet) për të fituar stilin popullor, për të krijuar një muzikë popullore, të kuptueshme për të gjithë, e përqëndron punën e tij në një lloj imitacioni të thjeshtë të melodive e këngëve popullore, duke i karakterizuar këto punë një primitivizëm i theksuar. Duhet kuptuar se në folklorizëm bije në kundërshtim të hapët ideja me mjetet e saj shprehëse. Folklorizmi nuk është në gjëndje të shprehë mendime të reja që përmban tematika jonë e sotme. Por a mos do të thotë vallë kjo se për faj të këtij fenomeni duhet të shkëputemi nga folklori? Asnjëherë jo. Trashëgimia jonë e madhe, jashtëzakonisht e bukur, këngët tona plot gjallëri e freski ritmike dhe melodike duhet të formojnë bazën e krijimtarisë sonë shprehur në gjuhën tonë të re muzikale. Për të arritur këtu e për të kuptuar arësytet e duhura mund t'i hedhim një sy historik këngës popullore, evolucionit të saj, funksioneve të saj në shoqërinë tonë, kuptimit dhe rolit të saj në jetën e popullit tonë. Sa më i thellë që të jetë shikimi ynë në këtë drejtim, sa më tepër t'i hymë brenda karakteristikave dhe shpirtit të saj, t'i futim këto në vetëdijen e gjakun tonë, aq më të fuqishme do të jenë tingujt e melodive të krijuara nga ne, aq më kjartë, jetëdhënëse dhe e kuptueshme do të jetë gjuha e re muzikale, lindur nga ndjenjat tona. Aq sa i domosdoshëm është brumi popullor në punën e krijimtarisë, më tepër se aq i domosdoshëm, bile me karakter determinant, është njohja dhe studimi i thellë i tij.

Që të shkuash për popullin duhet ta njohish mirë atë, aspiratat e

tij edhe në të kaluarën, dëshirat e tij më intime; që t'i flasish atij sinqerisht e kuptueshëm duhet t'asimilosh gjithë format shprehëse që ai ka përdorur domethënë esencën e gjuhës së tij muzikale mishëruar në mënyrën më të përsosur në këngën popullore që ai e ka krijuar vetë. Jo vetëm për këtë arësye por edhe për faktin se lufta jonë kundër estetikës borgjeze me të gjitha rrymat e ndryshme të drejtimit të saj: formalizëm, kozmopolitizëm, subjektivizëm etj. na vë detyra që t'i afrohem sa më tepër krijimtarisë popullore. Në këngën popullore gjejmë realizëm të thellë, patriotizëm popullor. Pa le t'i sjellim në mendjen tonë, për një çast, gjithë ato këngë trimërieje të maleve tona, pa le t'i kalojmë shpejt e shpejt domethanjen e tyre në vetëdijen tonë; çfarë madhështije, çfarë monumentesh të mrekullishëm të patundur dhe të paprekshëm mbajnë lart lavdinë e këtij populli. Jo më kot populli e dëgjon me kujdesin e vemendjen më të madhe këngën e Zek Jakinit në koncertet e Estradës, melosin e saj epik, karakterin e saj burrnor që përjetëson aktin e papërkulshmërisë ndaj feudalëve të djalit të thjeshtë të popullit Zek Jakini. Pa të hidhemi në këtë drejtim edhe në këngët e trimërisë të Shqipërisë së Mesme që motivojnë të njejtën tematikë. Të ndalemi në këngën e thjeshtë të Cen Kavajës. Ndonse në estensionin e një kuinte të vetme plus septimën e vogël në kadencë, në omofoninë më të theksuar, ajo këngë ka cilësi e karakter të tillë emocionant sa që të rrëmben me të njejtën forcë që mund të të rrëmbente një vepër e madhe plot me frymëzim. E ajo që është më e madhja, që vërteton më së miri për lartësinë e mendimit të saj, për thellësinë e ndjenjave, është fakti se edhe po ta dëgjosh vetëm me instrument, pa fjalë, pa i ditë edhe përmbajtjen fare, ajo kujtudo i kujton kjartë se për cilin e për ç'gjë flitet. Kemi të bëjmë në këtë rast me kuptimin më të lartë të vërtetësisë muzikale, me realizmin më të plotë, me karakterin më të përsosur të mishërimit të idesë e të përmbajtjes në gjuhë e tinguj muzikorë plot me kjartësi, me një shembull të lartë krijonjës. Po t'i hedhim një vështrim këngëve të Jugut po të këtij karakteri, ato shprehen më të ritmuara, më të theksuara, me karakter masiv, kjo edhe për arësye se duke kënduar kërcëhet. Veç kësaj ata kanë veshjen e tyre polifonike që u jep kompozitorëve të tjera elemente për të formuar gjuhën e tyre muzikore me karakter nacional. Nuk janë vetëm këngët e vallet tona të këtij lloji, por gjithë trashëgimia jonë popullore formon një bazë të madhe mjetesh e materiali që i japin mundësi të madhe kompozitorit të shprehet në frymën e idesë së re. Këngë të tjera lirike e dasme të Veriut të Shqipërisë së Mesme e të Jugut dëshmojnë më së miri për këtë gjë. Folklori ynë na siguron elementë të shumtë jo vetëm epikë, lirikë por edhe në satirë, sidomos këngë të Shqipërisë së Mesme. Ai na siguron një seri nuancash e karakteresh më në veçanti, më të detajuara që janë të domosdoshme për pendën e kompozitorit. Çfarë fineshe dhe elegance ruhet për shembull në vallet dhe në këngët e ndryshme të Shqipërisë së Mesme (më tepër ato të dasmave), çfarë rezonance e gradacione dinamike deri në mundësitë finale të një fortissimo kulminante në forma të gjera mund të dalin nga vallet e Veriut, çfarë kantabiliteti e melodie të ngrohtë mund të nxirret nga këngët e Kosovës, të Zadrinës e të Shkodrës po për çfarë përshkrimesh muzikale me karakter pastoral mund ta ndihmojnë kompozitorin meloditë e këngët e Jugut (Pogradec, Korçë etj.) Të gjitha këto të dhëna na bindin për një gjë të vetme: se kënga popullore, karakteristikat e saj të brendëshme, domethënja e saj, kriteri me të cilin populli i thjeshtë ka konkretizuar mendimet e tij me

tinguj muzikorë, duhet të formojnë bazën e muzikës sonë të re. Dhe kjo sepse vetë kënga popullore e përmban këtë bazë e këto cilësira e kompozitori profesionist ka të drejtë të vëjë dorë në talentin e tij për t'i zhvilluar më tutje ato, në konditat e reja.

Po çfarë i mungon pra këngës popullore që të ketë karakter determinant në krijimin e muzikës së re në formë nacionale? Pse folklorizmi, që në fakt është të imituarit në mënyrën më intime të këngës popullore, të jetë pengesë në rrugën drejt krijimit të gjuhës së re muzikore? Sepse vetë kënga popullore, megjithëse me një pasuri të gjithanëshme inspiracioni dhe vërtetësisje, vetëm nuk i përgjigjet dot të gjitha kërkesave, që i shtron mendimi i ri. Ajo vetëm për vetëm nuk mjafton për të plotësuar nevojat shpirtnore të shoqërisë së re, për të plotsuar figurat ideo-artistike të kohës sonë. Këtë na e vërteton gjithë historia, jeta, ndryshimet që kënga popullore ka patur në jetën e gjithë popujve. Këtë na e vërteton edhe përvoja e rruga nëpër të cilën kënga jonë popullore eci gjatë kohërave e sidomos gjatë këtyre vjetëve të fundit. Dihet se krijimtaria muzikale popullore, e lindur bashkë me nevojat më të para të njeriut, me gjuhën e tij kur masat e gjera ishin të vetmet përfaqsonjëse të vetë jetës, krijoi këngën popullore, e cila paraqiti në vetvehte një pjesë të mirë të karakteristikave të ndryshme që këto masa ruanin në brendinë e tyre. Në bazë të konditave historike të çdo kombi, t'okupacioneve të ndryshme që pësuan popujt kush më shumë e kush më pak, të konditave gjeografike, të konditave materiale të shoqërisë etj. edhe gjuha muzikale filloi të fitojë një lloj veçantije nga pikëpamja e kualitetit dhe e karakterit, veçori që nuk ishin të njëjta për çdo komb. Kjo bazë duke shprehur të gjitha aspiratat e nevojat e jetës, në konditat e zhvillimit të shoqërisë në atë kohë, ruajti njëkohësisht veçanti nacionale në të gjithë popujt. Me gjithë këtë, thesari popullor i gjithë popujve ka ç'prej asaj kohë diçka të përbashkët sidomos me popujt fqinj. Këtu ne gjejmë edhe arsyet e ndikimeve të ndryshme që hasim në muzikën tonë popullore dhe reciprokisht në influencat e muzikës sonë në muzikën popullore të fqinjve. Nuk kanë qënë pjesët apo elementet e ndryshëm ritmikë, armonikë, intervale të ndryshëm melodikë e të tjera karakteristikë të marruna veç e veç që kanë determinuar për të shprehur përmbajtjen e mendimit, të idesë dhe të figurës që ka kënduar populli, por i tërë kompleksi i këtyre elementeve të marrë të gjithë së bashku në një mendim unik muzikor. Kjo gjë na vlen shumë për studimin e melodive tona popullore dhe sidomos më tepër për kriterin e punës sonë në krijimin e gjuhës së re muzikore, përgënjeshtrohet më së miri gjithë shtrembërimet e estetikës idealiste dekadente, kompozitorët e së cilës, në krijimtari e sipër, nisen nga efektet e jashtëme, të çkëputura nga mendimi bazë, nga ideja, duke i vënë këto në plan të parë mbi idenë ose duke e asgjësuar fare idenë.

* * *

Në vendin tonë, ku popullit e kompozitorëve iu krijuan me të vërtetë kushte që të njohin e të krijojnë mbi folklorin, ngjau (më tepër në fillim) dhe vazhdon ende të vërtetohet fenomeni i folklorizmit. Bukuria e fisnikria e motiveve tona popullore, përhapur nga grupe e ansamble popullore dhe amatorësh, tërhoqi vemendjen e kompozitorëve tanë. Për ta elementi popullor u bë faktor kryesor në punimet e para të tyre dhe në rrugën e më pastajme. Përpunimit dhe harmonizimit të këngëve popu-

llore iu vunë me kujdesin e zellin më të madh. Puna e kompozitorëve Kastandin Trako, Kristo Kono, Prenkë Jakova, Dhora Leka, Pjetër Dingu, Çesk Zadeja, Tish Daija, Simon Gjoni, Eftim Dheri etj. është mjaft e ndijëshme në punimin, armonizimin dhe aranzhimin e këngës sonë popullore për kore, zëra të ndryshme e për instrumenta. Sigurisht se, si punimet e para pa ndonjë traditë në këtë drejtim, ato kanë të metat e tyre sëbashku me anët pozitive. Në radhë të parë thurja e tyre armonike përqëndrohet rreth një sasije shumë të ngushtë akordesh klasikë me karakter elementar. Në këtë rast kënga dhe melodia e popullit jo vetëm që nuk pasurohet me element të ri në karakterin e saj esencial, por duke u mbushur me armoni të pa studjuar mirë, zbehet dhe humbet, sipas punimit, bukurinë e saj. Arësyeja e dytë: vetë këto akorde nga pamjaftueshmënia e pregatitjes profesionale të kompozitorëve, në periudhën e parë të punës së tyre si edhe përdorimi i tyre, nuk janë bërë me ndonjë kriter të shëndoshë shkencor dhe artistik. Përvoja e punës, zgjerimi i përditshëm i horizonteve të tyre, përvoja e muzikës sovjetike ndikoi të shënohen edhe sukseset e mira në rrugën e kompozitorëve tanë. Po të analizojmë krijimet e Kastandin Trakos p.sh.: ato të motivit «Besës Shqiptare» e «Parë kush ta preu fustanë» etj. që paraqiten mjaft të ngarkuara harmonikisht e nganjëherë me një zhvillim dhe përcaktim forme jo fort logjike, në disa të fundit e sidomos në disa krijime të tij «Urim Stalinit», «Kombinatit Sheqerit 8 Nëndori» etj. do të konstatojmë një kthesë të mirë drejt një pune me kriter më të shëndoshë përsa i përket punimit dhe të përdorurit të folklorit si bazë të gjuhës së re muzikale. Ajo që është pozitive tek ai është fakti se karakteri popullor në esencë ndihet edhe në veprat më serioze sikurse është «Kantata Partisë e Enverit». Kompozitori Kristo Kono e filloi punimin e folklorit qysh në punimet e tij të para në një fushë edhe më të gjërë, duke u marrë që në fillim jo vetëm me punime vokale dhe korale po edhe me ato instrumentale: «Fantazia Shqiptare», «Bredhat e Drenovës», «Borova Martire» dhe më vonë «Labëria». Me gjithëse larg nga motive të caktuara popullore, pjesa e parë e «Bredhave të Drenovës» paraqitet me inspiracion mjaft të ngrohtë. Duke mishëruar në mënyrë të sinqertë idenë, veprës nuk ka se si t'i mungojë karakteri nacional në esencë. Momente, ku kompozitori ia ka dalë mirë qëllimit në këtë drejtim, janë dhe disa nga format e vogla të tija si «Kanali i Myzeqesë», «Disa çaste të Labërisë» në polifoni popullore (pjesa e rindërtimit). Krahas anëve pozitive të këtyre veprave, karakteri folkloristik, bashkë me të metat e tjera profesionale, është gjithashtu i theksuar.

Në rrugë të mirë në këtë drejtim është paraqitur puna e kompozitorit Prenkë Jakova me «Grunin e ri» dhe mjaft vende në veprimin e tij muzikal «Dritë mbi Shqipni». Ai ka treguar se mund të shkohet edhe më me sukses drejt zgjidhjes së këtij problemi shumë të rëndësishëm. Arja e Mrikës si dhe kënga e Hidrocentralit është provë e mirë e faktit se çka mund të ndërtohet mbi melosin dhe bazën e shëndoshë të folklorit tonë në konditat e reja. Sigurisht se me një teknikë më të avancuar profesionale, me mjete armonike dhe polifonike më të pasura, me saktësi më të drejtë forme, vepra «Dritë mbi Shqipni» do të dilte pa dyshim shumë më e mirë dhe më emocionante.

Manifestime folklorizmi gjënden në mjaft punime të kompozitorëve tanë. Kompozitori Pjetër Dingu, që është marrë me folklorin e Veriut dhe të Shqipërisë së mesme, ende me vështirësi, shkëputet nga pozitat e

folklorizmit. Në shumë punë të tij dhe sidomos në dy tabllotë muzikale fryma e folklorizmit është e rëndë. Në këngën «Moj e mira» ep shenja të mira përmirësimi. Duke u marrë, në përgjithësi, me analizën e punës të kompozitorëve të tjerë, të gjitha të dhënat vërtetojnë se folklorizmi egziston ndër ne, me gjithë që pasqyra e mësipërme përmban edhe rezultate pozitive për t'u larguar nga këto pozita e për të përqafuar rrugën nëpër një formë të drejtë nacionale në muzikë.

Megjithë se ndër ne gati të gjithë kompozitorët, kush më pak e kush më shumë, e njohin dhe janë marrë me folklorin, prap se prap rezultatet tregojnë se njohja nuk është e thellë. Shumë prej nesh kur flasim për sekonda të smadhuar, septima të zvogluar ritmi të përzier, për polifoninë dy dhe tri zanore të jugut e tjera, i marrin të shkaputur këto në vet-vete nuk i lidhin si elemente të domosdoshëm dhe esenciale, me të dhënat e duhura që japin jetë e shpirt së tërës që flet, mendimit muzikor.

Kënga popullore marrë si bazë për gjuhën e re muzikale të popullit, duke zhvilluar në të shpirtin dhe karakterin më intim të saj dunet të ngrihet në pozita të tilla, që të jetë në gjendje të shprehë drejt të gjitha idetë dhe ndjenjat, të cilat populli i ka jetuar, i jeton dhe do t'i jetojë në gjirin e një forme të vërtetë, me atë të muzikës së vërtetë nacionale. Jo pra imitacion pasiv i melodisë popullore as i armonisë së saj, polifonisë dhe të tjera të dhëna karakteristike, por esenca, shpirti. Veçantia e specifikes armonike, ritmike, polifonike, madhështia e të shprehurit të një mendimi muzikor të caktuar e të ngritur nga mendja dhe ndjenja e kompozitorit profesionist, duhet të krijojnë bazën e re me një mjeshtri të përsosur artistike.

Sa drejt shprehet Odojevski kur thotë: «**Formë nacionale do të thotë flakë shumë e madhe por kuptimi i saj i kapur në mënyrë jo të drejtë mund të çojë në gjëra fare pa kuptim, në të përsëriturit qorrizi të asaj që bënë të parët, dhe kjo jo vetëm se ata e bënë drejt por vetëm sepse e bënë ata**».

Puna dhe jeta e kompozitorëve më të mëdhej realistë dëshmon se njohja e folklorit është e lidhur ngushtë me të jetuarit e tij, me esencën e tij. Duke jetuar në fshatra dhe dasma u edukua shpirti dhe gjuha muzikale thellësisht popullore e veprave gjeniale të Glinkës, Musorgskit, Çaikovskit. «**Sa për elementin rus në muzikën time, ajo vjen prej faktit se unë u rrita jashtë kryeqytetit**» shkruan Çajkovski. Fakti që Musorgski, duke përdorur vetëm pesë tema popullore autentike në veprën e tij të madhe «Fiovanshina» ka bërë një opera të tërë edhe më popullore se temat e vërteta, ai na tregon se sa mundësi të pashtershme inspirimi i jep kompozitorit materiali popullor i studjuar dhe i kuptuar thellë. Duke folë për Korsakovin, akademiku Asafjev, na thotë se ai ishte shumë i lumtur kur ia dilte qëllimit të krijonte melodi të tilla që nuk i ngjajshin asnjë kënge të caktuar popullore, por që ishin krijuar në bazë të melosit popullor. Dhe më tutje kompozitori i mirënjohur sovjetik, Aran Kaçaturjan thotë: «**Sido që e kam ndryshuar dhe prefekcionuar guston time muzikore, baza autentike nacionale, të cilën e kam jetuar vetë në vjetët e fëminisë në marëdhënie me popullin, mbeti themeli më i natyrshëm për krijimet e mija**».

Krahas me këtë nuk duhet harruar ajo që është më e rëndësishmja se gjuha muzikore e krijuar në veprën artistike, që nuk i përgjigjet mendimit, kuptimit të idesë e të përmbajtjes megjithëse ka karakter e formë nacionale, nuk ka asgjë të përbashkët me karakterin e vërtetë popullor. Në këtë rast melodia popullore merret vetëm si model për t'u punuar

pa u ngritë në lartësinë e saj të vërtetë pa qënë një shprehje e vërtetë reale e mendimit, që shtjellohet në vepër. Bjelinski na mëson se **çdo formë që pasqyron drejt jetën është edhe nacionale**.

Pa njohjen dhe pasqyrimin e vërtetë të jetës edhe forma nacionale zbehet ashtu si pa të shkrihet e tërë përmbajtja.

Në kontakt me literaturën e klasikëve më të mëdhej të botës, e klasikëve rusë dhe, para së gjithash, e kompozitorëve sovjetikë, kompozitorët tanë do të gjejnë rrugë për zgjidhjen e shumë problemeve, që do të hapin rrugën tonë drejt suksesesh të mëtejshme. Detyra të mëdha për përpjekje gjithënjë më intensive u bijen vetë kompozitorëve tanë. Por edhe Lidhja e Artistëve duhet t'u krijojë atyre mundësitë e kondita zhvillimi dhe edukimi. Është e vërtetë se veç folklorizmit janë edhe probleme të tjera që ende nuk i lënë vend një krijimtarije më profesionale dhe të drejtë. Çështja e formës muzikale, e një armonije më të pasur e të avancuar, e polifonisë, e dramaturgjisë muzikale, që janë elemente të domosdoshme për suksese në krijimtari, duhet të preokupojë kryesinë e Lidhjes së Artistëve. Është mirë që puna praktike e kompozitorëve, analiza e veprave të tyre, analiza e veprave të kompozitorëve më të mirë sovjetikë e botërorë, puna për një zhvillim të mëtejshëm të botëkuptimit dhe horizonteve të tyre të zërë vendin e duhur krahas konferencave me karakter parimor të përgjithshëm jo të lidhura me gjendjen e veçantë në të cilën ndodhet krijimtarija jonë. Krahas me të, mbledhja dhe studimi artistiko-shkencor i folklorit në mënyrë të organizuar nga institucionet përkatëse, do të ndihmojë për suksese më të mira drejt një forme me të vërtetë nacionale në muzikën tonë.

Në zgjidhjen e problemit të folklorizmit dhe të formës nacionale është metoda e realizmit socialist që na ndihmon në mënyrë të vendosur.

Vetëm ajo na çon drejt një forme me të vërtetë nacionale, në të cilën përmbajtja socialiste gjen shprehjen më të drejtë duke tingëlluar me vërtësinë më të madhe, me karakterin më të thellë popullor.

U kthye n' atdhe delegacioni ynë kultural që vizitoi Bashkimin Sovjetik

Me datë 12 të dhjetorit që kaloi u kthye n' atdhe delegacioni kultural që vizitoi Bashkimin Sovjetik me ftesën e VOKS-it (Shoqërisë së Bashkimit Sovjetik për marrëdhënjet kulturele me vendet e huaja).

Delegacioni qëndroi në Bashkimin Sovjetik më se një muaj dhe vizitoi Moskën, Leningradin, Minskun dhe Tashkentin. Ai u prit kudo me një miqësi dhe dashuri të thellë nga gjithë punëtorët, kolkozianët dhe njerëzit e artit e të kulturës me të cilët pati kontakt. Disa anëtarë të delegacionit tonë folën në mbledhje publike mbi Republikën popullore të Shqipërisë.

Me dt. 15 dhjetor 1953 delegacioni ynë kultural, i kryesuar nga shoku Fadil Paçrami, bëri një vizitë në Ambasadën sovjetike. Delegacioni shoqërohej nga shoqja Nexhmije Hoxha, nënpresidente e Shoqërisë së Miqësisë Shqipëri-Bashkimi Sovjetik. Anëtarët e delegacionit i shprehën të ngarkuarit me punë a. i. të Bashkimit Sovjetik Z. Kabanov dhe përfaqsonjësit të VOKS-it në Shqipëri, Biellov admirimin për gjithçka panë dhe vizituan në Bashkimin Sovjetik; për ndërtimet e mëdha të komunizmit, për jetën e begatëshme dhe të lumtur të shtetasve sovjetikë, për zhvillimin e madh dhe të gjithanëshëm të kulturës, artit dhe shkencës. Ata thanë se kthehen n' atdhe me përshtypjet më të mira, se vizita në Bashkimin Sovjetik, do t' u vlejë si eksperiencë në punën e tyre të përditëshme dhe se gjithçka që panë do t' u bëjnë të njohur masave punonjëse të vendit tonë.

Me dt. 17 dhjetor, Presidiumi i Shoqërisë së Miqësisë Shqipëri-Bashkim Sovjetik, u mbledh për të

dëgjuar raportin e kryetarit të delegacionit kultural, shokut Fadil Paçrami, mbi vizitën që bëri delegacioni në Bashkimin Sovjetik. Shoku Fadil Paçrami, si falënderoi VOKS-in në emër të delegacionit për ftesën e berë dhe për kujdesin që u tregua për të gjatë qëndrimin në Bashkimin Sovjetik, foli për sukseset e mëdha që kanë arritur popujt e B. S. në ndërtimin e komunizmit, si dhe për dashurinë e madhe që ushqen populli sovjetik për popullin shqiptar. Presidiumi diskutoi dhe aprovoi një plan për konferencat dhe mbledhjet që do të zhvillohen nga anëtarët e delegacionit në gjithë Shqipërinë.

Planin e konferencave e hapi shoku Fadil Paçrami në mbrëmjen e datës 23 Dhjetor me konferencën që u organizua në sallën e kinemasë së «Brigadave». Salla e kinemasë ishte mbushur plot me punonjës të qendrave të ndryshme të punës, me studentë, nëpunës, etj.

Në fjalimin e tij shoku Fadil Paçrami, pasi përmendi se delegacionet e njerëzve tonë të kulturës me vizitat e tyre në Bashkimin Sovjetik njihen nga afër me përparimet e mëdha në të gjithë sektorët e jetës në Bashkimin Sovjetik dhe se kur kthehen n' atdhe u lind dëshira për t' u treguar bashkëatdhetarëve të tyre sa më shumë nga ato që kanë parë, tha:

«Duhet përmëndur që në fillim se delegacioni ynë kultural vizitoi Bashkimin Sovjetik një vit pas Kongresit të 19-të, i cili hapi rrugët për ndërtimin e komunizmit, dhe pas një seri vendimesh të rëndësishme që synojnë në një përmirësim të mëtejshëm të jetës materiale e kulturele të popullit Sovjetik, siç janë

ato të Sesjonit të pestë të Sovjetit Suprem dhe ato të plenumit të Komitetit Qendror të Partisë Komuniste të Bashkimit Sovjetik të muajit shtator të këtij viti, Ne patëm rastin të shohim nga afër entuziazmin që krijon puna që ata bëjnë sot për realizimin e një qëllimi të tillë të shenjtë, siç është ndërtimi i komunizmit, që do të thotë të krijosh bollëkun për të gjithë, një jetë të kulturuar dhe plotësimin e të gjitha nevojave të njeriut. Ne pamë përpjekjet e njerëzve sovjetikë për zbatimin e këtyre vendimeve, të cilat janë sot një program pune për çdo njeri, që nga nxënësit në shkollën «Zoja Kosmodemjanskaja» në Moskë tek puntorët e uzinës së traktorëve në Minsk, tek kolkozianët e njohur për rendimente të larta në pambuk në Tashkent, ose artistët e njerëzit e kulturës në Leningrad, me të cilët biseduam. Ne pamë gjithashtu bollëkun, nivelin e lartë të jetesës e të kulturës që kanë qysh tani njerëzit sovjetikë, që ka krijuar për ta socializmi dhe marshimi drejt komunizmit. Dhe kur mendon se pas 2-3 vjetësh mallrat e konsumit dhe prodhimet bujqësore e blegtarale do të dyfishohen, gjë që do të thotë se në magazinat e ushqimit e të veshmbathjes do të ketë 2-3 herë më shumë ushqime e veshmbathje dhe njerëzit sovjetikë të kenë 2-3 herë më shumë nga sa kanë sot, atëherë kupton më mirë se çdo të thotë të ndërtosh komunizmin.

Pastaj shoku Fadil Paçrami duke folur për vizitat e delegacionit në qendrat e ndryshme kulturele, në muzeumet, pallatet e kulturës shkollat e institutet e larta, tha: Një ditë të terë ne qëndruam në universitetin e ri të Moskës, i cili, siç dihet, u inaugurua disa kohë më përpara. Kryenxhineri që e ka projektuar, akademiku Rudnjev, na spjegoi se universiteti ka 27 ndërtesa dhe 10 godina ndihmëse. Godina ka 32 kate dhe është 239 metra e lartë, ka një kopsht botanik prej 42 ha., palestra, një observator as-

tronomik. Këtu do të mësojnë rreth 12.000 studentë dhe për 6.000 prej tyre janë siguruar dhoma banimi të veçanta. Universiteti ka një bibliotekë prej 1.200.000 volumesh dhe laboratorë të ndryshëm, të pajisur shumë mirë. Duke na treguar për problemet që u dolën përpara projektonjëseve, akademiku Rudnjev tha se patëm parasysh të ndërtojmë një universitet të tillë që edhe pas 200 vjetësh njerëzit e komunizmit të thonë se këtu mund të mësohet e të jetohet akoma.

Duke folur pastaj për vizitën e delegacionit kultural në Minsk e në Tashkent, shoku Fadil Paçrami me anë shifrash tregoi përparimet e mëdha të bëra në fushën e kulturës në Republikën socialiste sovjetike të Biellorusisë dhe zhvillimin kultural në Republikën socialiste të Usbekistanit.

«Ne vizituam uzina të mëdha, tha pastaj shoku Fadil Paçrami, si atë të traktorëve dhe uzinën e automobilave në Minsk, kombinatin e madh të tekstilit «Stalin» në Tashkent, fabrikën e këpucëve në Minsk, etj. Vizituam gjithashtu stacionin e mekanizimit të bujqësisë, një sovhoz, një S. M. T. dhe një kolhoz në Tashkent. Kudo pamë zhvillimin e madh të industrisë dhe të bujqësisë sovjetike».

Duke përfunduar fjalimin e tij, shoku Fadil Paçrami tha:

«Te populli shqiptar, populli Sovjetik ka një mik të madh, na thanë në Moskë, në Leningrad e në Odesë; dhe kur themi një mik të madh, këtë miqësi nuk e matim me numurin e banorëve që ka vendi juaj, por me vendosmërinë e popullit shqiptar për të ecur bashkë me popujt sovjetikë e me gjithë kampin e socializmit e të paqës për sigurimin e paqës në botë.»

Një përshtypje të thellë i bëjnë njeriut të tilla fjalë për atdheun e tij, kur e sheh të rrethuar nga një miqësi e tillë e ngrohtë. Atëhere e ndjen më fort veprën e Partisë sonë të Punës me shokun Enver Hoxha

në krye, që i siguroi popullit tonë një mik kaqë të vyer kaqë të madh si Bashkimin Sovjetik.

Fjala e shokut Fadil Paçrami u dëgjua me vëmëndje. Të pranishmit brohoritën për Bashkimin Sovjetik, për Partinë Komuniste të Bashkimit

MBLEDHJA PLENARE E LIDHJES SË ARTISTËVE

Më 25 dhe 26 Dhjetor 1953, u zhvillua në Tiranë mbledhja plenare e Lidhjes së Artistëve të R. P. të Shqipërisë. Në këtë mbledhje merrnin pjesë kompozitorë, piktorë, skulptorë, artistë nga të gjitha anët e Republikës.

Referatin mbi punën e Lidhjes gjatë vitit 1953 e mbajti nënkryetari i Lidhjes shoku Mustafa Krantja, i cili mbassi theksoi kujdesin e madh që tregoi Partia dhe Qeveria për të drejtuar punën artistike në bazë të metodës së realizimit socialist, faktor kryesor i një sërë suksesesh dhe anësh pozitive në punën artistike, vazhdoi:

—«Gjatë vitit 1953 aktiviteti i antarve dhe kandidatëve të Lidhjes si dhe i gjithë njerëzve të artit në përgjithësi ka qënë i mirë. Tërë lëvizja jonë artistike profesioniste dhe diletante ka ecur përpara. Në proporcjone dhe forma të ndryshme si mbas sektorëve të ndryshëm janë bërë kthesa të rëndësishme si në prodhim, ashtu dhe në ekzekutim.

Në muzikë përpjekjet e kompozitorëve tanë për të konkretizuar forma më të gjëra muzikale kanë qënë të shumta e në përgjithësi me rezultate të kënaqëshme si fillim. Kompozitorët Kristo Kono, Kostandin Trako, Prenk Jakova, Pjetër Dungu e Tonin Harapi shënojnë punime të rëndësishme në këtë

Sovjetik, për Partinë tonë të Punës dhe për shokët Malenkov dhe Enver Hoxha.

Pas konferencës u çfaq filmi «Tahikistani sovjetik» dhe dokumentari «7 Nëndori 1953».

drejtim si p.sh. vepra: «Agimi» e Kristo Konos, oratori «Partija» e Kostandin Trakos dhe tablo të ndryshme muzikale të shokëve të mësipërm. Rezultat të mirë dhe sukses të ndijshëm në krijimtarinë tonë shënojnë veprat e kompozitorëve Dhora Leka (Uvertura mbi tri tema popullore shqiptare dhe sidomos vepra e saj e fundit kantata «Shqipëri, o vend i lavdisë» mbi tekstin e Andrea Varfit) edhe disa punime të Çesk Zadejës, si pjesëmarrja në kompozimin e muzikës së filmit «Skënderbeu», Tish Dajis, etj. E bollshme dhe që meriton vëmëndje ka qënë puna e kompozitorit Ramadan Sokoli, i cili me mjaft pasion e kriter të mirë artistik, punon, harmonizon dhe kompozon mbi bazën e folklorit tonë popullor. Krahas me këto edhe në forma të vogla, megjithëse, në sasi më të paka nga të parat, kompozitorët Abdulla Grimci, Baki Kongoli, Muharrem Xhediku, Koço Uçi e shokë të tjerë kanë bërë punë të mirë.»

Më poshtë Mustafa Krantja cilëson sukseset e mëdha që janë arritur gjatë vitit 1953 në skenën tonë lirike dhe në atë të prozës me vëniën në skenë të operas së kompozitorit të madh rus Dargomirzhkit, operas «Rusalka», dramës klasike «Otello» të Shekspirit dhe pjesës së shkrimtarit sovjetik Hysen Myf-

tari «Nderi i familjes», që janë garanci për një ritje të mëtejshme të cilësisë artistike në punën krijonjëse të Kolektivit të Filarmonisë dhe atij të Teatrit Popullor.

Duke analizuar punën e arteve figurative referonjësi tha:

—«Rezultate të zbeta shënojnë këtë vit artet figurative. Në kundërshtim me vitin 1952, vit në të cilin ata merituan dy çmime të Republikës, viti 1953 shënoi për ta një sasi jo të konsiderueshme veprash dhe si rrjedhim pak aktivitet nga ana e këtyre shokëve. Kemi patur në pikturë gadi 25 vepra, më tepër me tematikë peisazhi, nga të cilat më të mirat paraqiten punimet e shokëve Vangjush Miho, Kristina Hoshi etj. Në skulpturë kemi patur 6 busta herojsh.

— Viti 1953 ka qënë vit fitoresh për lëvizjen diletante të artit në vendin tonë. Kjo lëvizje me rëndësi jashtëzakonisht të madhe për lulëzimin e mëtejshëm të artit ka marrë proporcjone shumë të mëdha nga vjetet e tjera. Për këtë flet rritja e grupeve të ndryshme në kombine, qytete, qendra pune, fshatra, shtëpi kulture etj. Olimpiada të organizuara, konkurset e festivalet e ndryshme si ai i pionierëve, çmimet e ndryshme që janë fituar nga grupe dhe individë të ndryshëm. Në këtë lëvizje të madhe ndihma e njerëzve profesionistë nuk ka qënë e ndijshme.»

Duke folur mbi aktivitetin e Lidhjes së artistëve, shoku Mustafa Krantja përmendi një sërë konferencash bërë me rastin e përvjetorëve dhe jubileve të ndryshëm të klasikëve të shquar si kompozitorëve Çaikovskij, Shopen, Bethoven, Smetana. Është përkujtuar figura e aktorit të madh Aleksandër Moisiu, janë bërë konferenca me karakter ideologjik dhe profesional, të cilat kanë sqaruar mjaft probleme, janë bërë diskutime krijonjëse mbi punime kompozitorësh shqiptarë, e etj.

— Në gjithë këtë punë ne kemi ecë përpara sepse fuqive tona, vullnetit, talentit dhe vendosmërisë së njerëzve tanë u kanë ndritë rrugën përvoja e artit dhe e njerëzve sovjetikë.

— Puna jonë e deritanishme, vazhdoi referuesi, na detyron të njo him e të kemi parasysh edhe anët negative të saja dhe, më tepër se kaq, të zbulojmë arësyet e këtyre të metave, për t'iu shmangur në kohën më të shkurtër e me vendosmëri edhe më të madhe. Ay solli si shembëll varfërimin në krijimtarinë në artet figurative, shfaqje të folklorizmit në muzikë, nevojës së ngritjes ideo-profesionale dhe të mjeshtërisë artistike, që bëhen çdo ditë më urgjente dhe të rëndësishme dhe kjo për arsye të hovit të madh që ka marrë zhvillimi i artit në vendin tonë dhe nga kërkesat gjithnjë më të mëdha që ka dita ditës populli ynë art-dashës.

Duke përfunduar, shoku Mustafa Krantja tha:

—«Ne hidhemi në një vit të ri, në vitin e katërt të planit tonë 5 vjeçar. Lufta e masave tona punonjëse gjithënjë vjen e shtohet për rezultate sa më të mëdha e me kualitet sa më të mirë. Ne, njerzit e artit, kemi detyrë ta ndihmojmë këtë luftë me krijimet tona. Ne kemi çdo ditë para sysh triumfin e punës krijonjëse të popullit tonë, triumfin e luftës së tyre të madhe për të siguruar një t'ardhme më të bukur drejt sëlilës Partia e jonë me shokun e dashur Enver Hoxha në krye udhëheq popullin tonë. Është detyra jonë të shtojmë të gjitha fuqitë për ta pasqyruar këtë realitet të ndritshëm, për t'i kënduar atij me gjithë pasionin e zemrave tona, me gjithë forcat e talentit dhe kulturës sonë.»

Mbas referatit u bënë diskutime. Në fillim e mori fjalën piktori Abdulla Emmini, i cili foli mbi përshtypjet e tij gjatë vizitës në B.S. si anëtar i delegacionit të Shoqërisë së

Miqësisë Shqipëri-B.S. Pastaj me radhë diskutuan kompozitorë, piktorë, aktorë të Teatrit Popullor, skulptorë, delegatë të ardhur nga qarqet e ndryshme. Në diskutime u rrah çështja e ngritjes ideo-politike dhe profesionale, sidomos për kompozitorët, fillimi i një studimi shkencor të folklorit, nevoja e lidhjeve më të ngushta me qarqet, etj.

Në fund të diskutimeve foli shoku Foto Stamo, kryetar i Lidhjes së Artistëve, i cili, përveç çështjeve organizative të Lidhjes, iu dha përgjigje dhe një varg çështjeve që u ngritën gjatë diskutimeve.

Në fund mbledhja plenare e Lidhjes së artistëve aprovoi vendimin, ku thuhet midis të tjerave se-gjatë vitit 1953, në lëmin e arteve, janë korrur suksese të reja për hir të ndihmës së madhe të Partisë e të pushtetit popullor, për hir të përvojës së çmueshme të artit sovjetik. Vënia në skenë e operas «Russalka», realizimi i shkëlqyer i filmit të madh artistik, «Skënderbeu», ku muarën pjesë për të parën herë artistët tanë dhe punonjësit e kinematografisë shqiptare, krijimet muzikore në formë të zgjeruar të kompozitorëve shqiptarë, kanë forcuar punën e krijimtarisë në fushën e muzikës.

— Komiteti drejtonjës i Lidhjes së artistëve është përpjekur të vëjë në jetë Vendimet e Byrosë Politike të datës 26.XII.1952, që bëjnë fjalë mbi letërsinë e artin në vendin tonë. Më poshtë, në Vendim,

thuhet se, përveç sukseseve të mësipërme në veprimtarinë e Lidhjes së artistëve, ka një serë të metash dhe dobësish që kanë penguar rezultate më të mira në punë.

Një vënd me rëndësi në Vendim zënë format që Lidhja e Artistëve do marri për të ndihmuar antarët dhe kandidatët e saj në ngritjen e tyre profesionale dhe ideo-politike.

Duke marrë parasysh gjithë këto çështje dhe probleme, mbledhja plenare vendosi që të forcohet puna e Kryesisë dhe e Komitetit drejtonjës së Lidhjes dhe antarët e Komitetit të kryejnë detyrat që u ngarkohen.

Për nder të 10-vjetorit të çlirimit të Shqipërisë, mbledhja plenare e Lidhjes së Artistëve vendosi që gjithë aktiviteti krijonjës në lëmin e arteve të zhvillohet nën parullën «Për nder të 10-vjetorit të çlirimit të atdheut» duke trajtuar një tematikë nga lufta N.Çl. dhe nga përpjekjet e masave tona punonjëse për ndërtimin e bazave të socializmit e për mbrojtjen e paqes e të atdheut.

Nga mbledhja plenare e Lidhjes së Artistëve iu dërgua një telegram Sekretarit të Përgjithshëm të P.P.SH. dhe Kryeministër i R. P. të Shqipërisë shokut Enver Hoxha, në të cilin shprehej dashuria dhe gadhëmeria e antarëve dhe kandidatëve të Lidhjes për të vënë të gjitha forcat e tyre në shërbim të popullit, për lulëzimin e atdheut.

Dh. Leka

PREMIERA «NDERI I FAMILJES» NË SKENËN E TEATRIT POPULLOR

Më 19.XII.1953 Teatri Popullor çfaqti premierën «Nderi i familjes» të shkrimtarit sovjetik Hysen Myftari. Pjesa doli me sukses të plotë dhe publiku e priti me kënaqësi të madhe.

Subjekti i pjesës është shumë tërheqës, i thjeshtë dhe spektatori dëfrëhet dhe edukohet njëkohësisht.

Përmbajtja e pjesës shkurt është kjo: Të gjithë pjestarët e familjes së Allanit janë mbledhur për të marrë pjesë në Jubileun e 30 vjetorit të Allanit, që organizohet nga Drejtorja e hekurudhës dhe organizata bazë e partisë; janë mbushur 50 vjetë që Allan Merdanovi punon me vetmohim në hekurudhën e Ashkabadit. Ky stahanovist i vjetër respektohet nga të gjithë për shërbimet dhe punën e tij të ndershme. Mirpo gëzimi i familjes prishet, sepse Bajrami, djali i math i Allanit, kryetar kolkozi, ka shkelur statutin kolkozian, duke therrur tre deshë nga të kolkozit. E gjithë familja e dënon këtë veprim të dobët të Bajramit dhe me të drejtë e cilëson si kusar dhe si njollë të zezë për familjen e tyre. Bajrami nuk e kupton gabimin që ka bërë. Ay mendon se duke qenë hero i Bashkimit Sovjetik, një nga kryetarët e kolkozëve më të mirë të Turkmenisë, që s'ka kursyer asgjë për të mirën dhe lulëzimin e atdheut sovjetik, mundet më në fund të marrë diçka nga kolkozi për të nderuar miqtë. Atëhere Allani dhe gjithë familja e denoncojnë Bajramin si shpërdorues të pasurisë së përbashkët dhe njëkohësisht mbledhin të hollat për të vënë në vënd dëmin që i ka shkaktuar Bajrami Kolkozit. Bajrami më në fund e kupton fajin e tij. Dhe me guxim vendos të shkojë përpara kolkozëve për të bërë autokritikë të

ndershme. Allan Merdanovi dhe pjestarët e familjes, me ndërgjegje të pastër dhe të gëzuar, nisen për të marrë pjesë në jubileun.

Kjo pjesë është vënë në skenë nga regjizorja Zina Pano, e cila ka bërë një punë të madhe, duke ndërtuar një çfaqje me të vërtetë të bukur, tërheqëse, të rjedhëshme dhe shumë të qartë.

Kuptimi i karakterit optimist që ka pjesa, dinamizmi i saj, u mishëruan nga regjizorja Zina Pano dhe u shprehën në gjithë punën e saj komplekse, qoftë në orjentimin e figurave, që dollën në skenë të gjalla dhe të plota, me tipare të veçanta secila dhe njëkohësisht të lidhura dhe të bashkuara me mjeshtëri dhe me fuqi në idenë qëndrore të pjesës, në ndërgjegjen socialiste, në nderin e familjes. Kështu që përmbajtja ideologjike e pjesës, u shpreh me sinqeritet dhe me pasion, prandaj dhe depërtoi me efekt në spektatorët. Lëvizjet në skenë ishin të studjuara, të përshtatëshme për figurat, duke shprehur qoftë momentet intime të aktorit në rol, qoftë momentet e ndryshme të ansamblit të lidhura në një përmbajtje të plotë psikologjike, kështu që rritja e çfaqjes u bë në një mënyrë të thjeshtë, të bukur dhe bindëse, duke pasur gjithënjë parasysh situatat kryesore, të cilat u vunë në dukje me art dhe mjeshtëri nga regjia siç ishte p.sh. e gjithë skena zhvilluar në aktin e II-të, kur bëhet gjyqi i Bajramit përpara familjes. Po me aq hijeshi janë zhvilluar nga regjizorja Zina Pano edhe anët e çelura, të gëzueshme të pjesës siç është p.sh. ardhja e Bajramit dhe e nënës në aktin e I-rë, kur krijohet një atmosferë entuziasaste dhe që të mbush me gëzim.

Puna serioze dhe e thellë e aktorëve u bashkua në një të tërë me

punën e regjizores dhe të piktorit, prandaj çfaqja depërtoi me fuqi në spektatorët.

Interpretimi i Pjetër Gjokës në rolin e Allanit ishte me të vërtetë i fuqishëm. Ay krijoi figurën e një babai të dashur e të ndershëm. Sidomos Pjetri mishëroi dhe shprehu me art Allani si qytetar të ndërgjegjshëm që s'ndahet aspak nga figura e babait, po përkundrazi bashkohet dhe bëhet një.

Dhëmbja, keqardhja dhe më në fund ashpërsia, pasqyrohen me sinqeritet të plotë dhe të thellë në fytyrën, sytë, zërin dhe lëvizjet e Pjetrit, kur ay (Allani) gjykon të birin.

Kadri Roshi e zgjodhi bukur dhe me kujdes vijën e rolit të Bajramit, sepse ay ruajti me besnikëri figurën e një heroi dhe birit të familjes së Allanit, zërnërbardhë, guximtar, të dashur, duke theksuar me mjeshtëri nga ana tjetër njerinë që s'e kupton gabimin dhe që fillon dalë nga dalë të bëhet mëndjemadh dhe të kryejë veprime të padrejta. Lufta e brëndëshme që zhvillohet te Bajrami, kur atë e bren dhe e mundon ndërgjegjia kur ay nuk është akoma i qartë, zhvillohet te Kadri në mënyrë graduale e të thjeshtë, kështu që kthesa që bën Bajrami në fund të bind plotësisht dhe të mbush me gëzim.

Naim Frashëri në rolin e Atës, krijoi një figurë interesante të intelektualit të ri sovjetik, intrasigjent dhe parimor kundrejt gabimeve të Bajramit. I mënçur, i dashur, puntor i palodhur dhe i ndershëm gjer në fund, ja disa karakteristika kryesore të rolit që Naimi i dha me hijeshi në skenë dhe me një brendi të plotë dhe tërë ndjenjë. Edhe anën e çelur të rolit Naimi e nxori të gjallë e plot ngjyra; dashuria e Atës për Zinën ishte shumë njerëzore dhe fisnike njëkohësisht.

Shumë interesante dollën në

skenë figura e Kurbanit, interpretuar nga Viktor Gjoka dhe ajo e Jazgolit, interpretuar nga Esma Agolli. Gëzimi entuziasmi dhe besimi i plotë për të ardhmen e tyre të lumtur në pushtetin sovjetik depërtoi me gjallëri në spektatorët nga interpretimi i Esma Agolli dhe Viktor Gjoka. Gëzimi dhe humori i tyre, nuk ishte gjë e rastit, por rezultat i mirëqënjes së tyre materiale dhe kulturele, që ka krijuar pushteti sovjetik për popullin dhe për rininë sovjetike. Interpretimi i tyre i gjallë e plot ndjenjë, theksuan në mënyrë tepër të kënaqshme karakterin optimist të pjesës.

Besa Imami në rolin e Zinës, interpretoi në mënyrë të rjedhëshme; dashurinë, që ushqejnë për te të gjithë pjestarët e familjes së Allanit; Besa, interpretimin e Zinës e bëri me dashuri dhe ngrohësi, duke marrë pjesë në gëzimet dhe hidhërimet e familjes; sidomos dashuria e fshehtë për Atën ishte interesante.

Violëta Manushi në rolin e Bikes krijoi figurën e nënës së lumtur. Interpretimi i saj ishte i thjeshtë dhe i ngrohtë, duke theksuar me kujdes dashurinë e saj si nënë e mirë, që ka rritur dhe edukuar shumë fëmijë dhe që sot është e nderuar dhe e dashur nga të gjithë.

Zenulla Hatibi në rolin e Alltiut e krijoi mirë figurën e të riut komсомolas guximtar e të ndershëm.

Një punë të kujdesëshme dhe me shije artistike ka bërë arkitekti i skenës Hysen Devolli, duke krijuar një ambient të përshtatshëm për zhvillimin e veprimit të pjesës; ambienti është i qeshur dhe i gjallë, qoftë në dekore, qoftë në kostume.

Realizimi me sukses i kësaj pjesë të bukur sovjetike në skenën e Teatrit Popullor, është aktuale për vendin tonë dhe do të ndihmojë mjaft për edukimin e masave tona punonjëse.

A. Malo

SKENARISTI MIHAIL PAPAVA TAKOHET ME SHKRIMTARËT DHE NJERËZIT E ARTIT E TË KULTURËS

Me inisiativën e Lidhjes së Shkrimtarëve të Shqipërisë dhe të Shoqërisë së Miqësisë Shqipëri-Bashkimi Sovjetik, me datën 4 dhjetor 1953 u organizue takimi i skenaristit të famshëm sovjetik M. Papava me shkrimtarët dhe njerëzit e artit e të kulturës të kryeqytetit tonë.

Në vendin tonë sot emni i M. Papavës asht i njoftun prej të gjithëve. Ai me një mjeshtri të rallë ka púnue bashkë me kryeregjizorin sovjetik Jutkeviç, filmin e madh artistik me ngjyra «Skënderbeu», i cili vazhdon të çfaqet në të gjitha kinematë e atdheut tonë. Ky takim i shkrimtarëve dhe i njerëzve t'artit e të kulturës me skenaristin M. Papava pat një randësi të madhe për vetë faktin, se M. Papava, jo vetëm dha eksperiencën e tij të çmueshme dhe u foli të pranishmëve mbi zhvillimin dhe përparimin e kinematografisë sovjetike, por vuni në dukje edhe cilat janë detyrat e shkrimtarëve dhe njerëzve t'artit të kinematografisë në përgatitjen dhe xhirimin e filmave.

Shoku M. Papava foli gjanë e gjatë mbi randësinë e skenarit. «Që në Kongresin e parë të Lidhjes Shkrimtarëve të Bashkimit Sovjetik, — tha ai, — iu kushtue një kujdes i veçantë randësisë së skenarit. Ai vuni në dukje se në film na kemi mundësi shumë të madhe shprehjeje, prandaj arti kinematografik asht ndër artet ma të randësishme. Në diskutimin e tij shoku M. Papava i kushtoi një vëmendje të posaçme planit krijues në kinematografi. Ai foli gjanë e gjatë mbi gjinitë e ndryshme t'artit kinematografik. Populli, — tha ai, — don të qeshi, pra asht krejtësisht e nevojëshme të bahen edhe filma satirikë. Këto forma, — tha skenaristi i mirënjoftun, — mund të provohen edhe në Shqipni.

M. Papava foli mandej për konizionin që duhet të ketë një veper kinematografike. — A asht e mundun, — tha ai, — që një roman, p.sh. të paraqitet në një film të gjatë vetëm një orë e gjysëm? A asht e mundun me paraqitë në një kenar gjithëçka asht shkruar mbi heroin e kombit shqiptar Skënderbeun? Sigurisht që jo. Prandej në kinematografi, duhet të paraqiten ngjarjet shkurt, pa cenue mbrendinë dhe historikun e ngjarjeve. Këtu qëndron zotsija e skenaristit.

Mandej shoku M. Papava foli mbi heroin në film dhe mbi subjektet historike dhe aktuale. Filmi i bukur artistik «Skënderbeu» kishte kuptimin e vet shumë të lartë, por përpjekjet e shkrimtarëve sot duhet të drejtohen ma tepër në periudha ma t'afërta, n'atë të luftës për çlirim dhe për ndërtimin e bazave të socializmit. Në vendin e socializmit, — tha ai, — puna asht shprehja ma e lartë, ku shkrimtari gjen materjal të mjaftueshëm për krijimet e tij, prandaj nuk mund të shkruiejë mbi një hero pa njoftë ma përpara punën e tij. Në qoftë se, p.sh. shkruiejmë mbi fshatarsinë, duhet dijtë e njoftë mirë puna e saj, sukseset e saj. Pa këtë cilësi të domosdoshme nuk mund të dalë një film i bukur dhe artistik. Nga materjali i mbledhun, duhet të zgjidhet ai ma i vlefshmi dhe ky duhet punue nga ana artistike. Pra të zgjedhurit e temës ka randësi të madhe dhe realizimi me sukses kërkon aftësi dhe mjeshtëri artistike.

Shoku M. Papava u dha përvojën e tij të çmueshme shkrimtarëve dhe njerëzve t'artit e të kulturës, përvojë e cila do t'u vlejë shumë në punën e tyre të ardhëshme për zhvillimin e artit të ri për vendin tonë, e artit kinematografik.

M. Mazi.

KONFERENCA E ORTOGRAFISË

Më 29 e 30 nëndor zhvilloi punimet Konferenca e Ortografisë e organizuar nga Instituti i Shkencave për të diskutuar rreth problemeve t'ortografisë sonë e rreth projektit të ri të ortografisë të përpiluar nga Sekcioni i Gjuhësisë e Letërsisë.

Një hap përpara në rrugën e normalizimit t'ortografisë sonë qe realizuar me rregullat që u përpunuan nga Sekcioni i Gjuhësisë e Letërsisë në vitet 1948-1949 dhe u botuan si broshurë më vehte në formën e tyre definitive më 1950. Kjo ortografi, mbasi nuk trajtonte të gjitha problemet e ortografisë sonë e nuk u ipte zgjidhje të gjitha vështirësive, kishte nevojë të zgjerohej e të plotësohej. Zhvillimi kultural e i përgjithshëm i vendit tonë e ngriti edhe më lart rëndësinë shoqërore të çështjeve ortografike dhe nxorri nevojën e një trajtimi më të plotë e më të mirë të tyre. Vepra gjeniale e J. V. Stalinit «Marksizmi dhe çështjet e gjuhësisë» dha mundësi që të shqyrtoheshin në një dritë të re problemet e ortografisë e t'u epet një zgjidhje e drejtë. Evolucionin e gjuhës letrare e i gjuhës së folur në rrugën e afrimit të dy dialekteve, evolucionin e problemit të gjuhës letrare kombëtare lejonin të hidhej edhe një hap tjetër përpara drejt një ortografie më të përcaktuar, më të njëzuar se ortografia e vitit 1950.

Ja përse doli nevoja e rishqyrtimit e plotësimit të saj. Kjo u ngrit me forcë të madhe në sesionet shkencore të vjetme t'Institutit, ku u rrahën problemet tona gjuhësore.

Sekcioni i Gjuhësisë e Letërsisë, duke parë kërkesat e shkollave, të shtypit e të letërsisë, nevojat e të cilave s'arrinte t'i plotësonte ortografia e parë, në bazë të konkluzioneve që nxori nga sesionet e

vitit 1953 vendosi që punën e shqyrtimit kritik, të plotësimit e të përsosjes s'ortografisë ta merrte në dorë menjëherë dhe të mos e linte për më tutje. Për të dalë një punë sa më e saktë, u organizua më parë një konsultim në lidhje me ortografinë e parë e me vështirësitë e paparashikuara në te, duke kërkuar vërejtje e sugjerime nga Ministria e Arësimit, organet e shtypit, redaksitë e ndryshme, etj. Ky konsultim, sadoqë nuk dha aq sa pritej, vlejti mjaft si për materialin që dha si për mendimet që u çfaqën.

Për hartimin e një projekti të ri t'ortografisë u ngarkua një komision i veçantë nën kryesinë e Z. Aleksandër Xhuvanit, i cili i dha fund punës së tij në tremujorin e tretë të vitit 1953.

Instituti i Shkencave duke ndje kur shembullin e shkencës sovjetike, e shtroi në një diskutim publik këtë projekt. Shkenca sovjetike na tregon se ç'përfundime pozitive mund t'arrihen në shkencë nëpër mjet të një pune kolektive, të një shkëmbimi e lufte mendimesh, të zhvilluar në baza të shëndosha parimore.

Projekti u shumëzua në formë dispense në një numur të mjaftueshëm kopjesh e u shpërnda. Në kuadrin e diskutimit të gjerë, u organizuan dy mbledhje paraprake diskutimesh, një me arsimtarët e Tiranës, tjetra me punonjësit shkencorë t'Institutit e bashkëpunëtorët e tij, si dhe Konferenca e Ortografisë.

Këtë mund ta quajmë si të parën Konferencë t'Ortografisë me karakter të gjërë në vëndin tonë. E kjo është e kuptueshme. Çështjet e ortografisë asnjëherë nuk kanë pasur rëndësinë shoqërore që kanë sot, kur populli ynë nën udhëheqjen e Partisë punon me

entuziazëm në përmbushjen e planit të parë pesëvjeçar të zhvillimit t'ekonomisë e të kulturës, kur është e afërtë zhdukja e analfabetizmit. Kultura po hyn gjithënjë e më tepër në masat e gjera të popullit e kjo bëhet kryesisht me anë të fjalës së shkruar. Një tekst me gabime gramatikore e ortografike, një ortografi kaotike e pastabilizuar bëhen pengesë për të kuptuarit në mes njerëzve e për përhapjen e kulturës në masat.

Pjesmarja e gjerë në Konferencë e në diskutimet treguan se kjo rëndësi është kuptuar dhe se problemet e ortografisë ngjallin interes në rrethe të gjera të jetës kulturele të vendit tonë. Në konferencë mirrnin pjesë punonjës shkencorë, quadro të Institutit ose bashkëpunëtorë të tij, arësimitarë, publicistë e redaktorë, shkrimtarë, etj. Qënë marrë masa nga Ministria e Arësimit që në Konferencë të merrnin pjesë edhe arësimitarë nga krahinat.

Konferencën e hapi shoku Zihni Sako, Kryetar i Sekcionit të Gjuhësisë e Letërsisë, që foli mbi rëndësinë e problemeve t'ortografisë, mbi nevojën e një ortografie më të plotë e më të stabilizuar dhe shprehu besimin se diskutimet e Konferencës do të jenë një kontribut i rëndësishëm për përpunimin e ortografisë në formën e saj definitive. Pastaj e mori fjalën Mahir Domi, anëtar i Komisionit t'Ortografisë, që referoi mbi parimet e kriteret që janë ndje kur në hartimin e projektit të ri.

Komisioni i vu vehtes për detyrë: a) të zgjerojë e të plotësojë ortografinë e mëparëshme; b) të shkojë një hap më tutje në njësimin e ortografisë, duke eliminuar, ku ishte e mundur, të shkruarit dy mënyrash; c) të rishikonte rregullat e ortografisë së mëparëshme, t'i saktësonte më mirë e t'i formulonte më drejtë e më qartë.

Në punën e tij ai u mbështet kryesisht në gjuhën e folur të sotme edhe në traditën e shkrimit të vështruar në zhvillimin e saj historik, pati parasysh evolucionin e gjuhës, tendencat e zhvillimit, pa u shkëputur nga gjëndja e sotme e saj. Në bazë ai vuri parimin fenotik, po ndoqi parimin morfologjik, kur ishte fjala për të zgjedhur në mes dy varianteve, e ndonjëherë edhe parime të tjera. Në njësimin e ortografisë e të formave, Komisioni mendoi të konsakrojë format që mund të merreshin si më të përgjithëshme, duke u mbështetur në përhapjen e tyre, në traditën e shkrimit, në tendencat e zhvillimit të gjuhës.

Projekti i ri del shumë më i gjërë e i plotë se ortografia e parë, parashikon shumicën e madhe të vështirësive e çështjeve ortografike që mund të paraqiten. Ai do të jetë i shoqëruar edhe nga një fjalorth ortografik. Në një numër rastesh, ai kalon në njësimin e formave e të grafive; ja disa prej tyre: a) bashkëtingëlloret e zëshme në fund të fjalëve do të shkruhen më të zëshme, edhe kur shqiptohen të pazëshme, pra i **madh, vend**, etj. (e jo i math, vënt); b) fjalët me e të theksuar të ndjekur nga një bashktingëllore hundore, të shkruhen edhe në toskërishtet me **e**, sikurse shqiptohen në gegërishtet dhe në disa vise të Jugut; pra **zemër, vend** (e jo zëmër, vënt); c) e-ja protonike do të ruhet në shkrim në gjithë ato rasa, ku e ka ruajtur toskërishtja, pra këtu arësye, anëtar, punëtor, pleqësi, miqësi; ajo bie gjatë lakimit të emrave me — **ël, ën** — a **ër, — ët, — ën**, e **izëm**; ç) ato fjalë, emra, mbiemra e folje që në gegërishtet nisin me parashitesën **sh** dhe në toskërishtet diku me **sh** e diku me **ç** do të shkruhen me **sh-**, pra **shkul, shkar-koj** (e jo çkul, çkarkoj); d) emrat mashkullorë, që e formojnë shumësin me — **nj a -j** sipas visevet, në

gjuhën e shkrimit do të marrin trajtën me -j, p.sh. ulli, ullij etj.

Po në mjaft raste ortografia le dy mënyra shkrimi, si pasojë të ndryshimeve dialektore e të fluktuacioneve të fazës së sotme të gjuhës sonë, Ajo pranon shpesh herë edhe përjashtime në rregullat e vendosura.

Në diskutimet muarën pjesë 20 e sa vetë, arsimtarë, shkrimtarë, punonjës shkencorë, etj. të cilët trajtuan probleme të ndryshme t'ortografisë ose bënë vërejtje e sugjerime. Folën kështu A. Xhuvani, L. Dodbiba, M. Reso, M. ndoja, E. Çabej, A. Puto, M. Gurakuqi, E. Kastriati, Shaban Demiraj, S. Spasse, Ilia Mitrushi. etj.

Të gjithë qenë të mendimit se projekti i ri shënon një hap të ri përpara në stabilizimin e ortografisë sonë e ka meritën të jetë i pasur e i gjërë. Për njësimin e formave e të grafive, në përgjithësi u shpreh vendimi se pikënisja është e drejtë, po për realizimin e tij pati edhe rezerva e vërejtje njëkohësisht me opinionet e çfaqura në favor. Në mjaft çështje u çfaqën ipinione të ndryshme, për e kundër, duke dalë kështu nevoja e themelimit të studimit të tyre për të gjetur argumenta bindëse në favor të njëres ose tjetres zgjidhjeje.

Nga çështjet më të kontestuara qenë: shkrimi me j apo pa j i emrave femërorë oksionë që mbarojnë me i (shtëpia apo shtëpia) e i

emrave të huaj që mbarojnë me -ia, -ie, -io, (special a specjal, karrocier apo karrocjer), shkrimi i j-së pas g-së e n-së e i h pas t-ës e d-ës (djegia, parathënia, tëholloj, etj.), përdorimi i theksit e i apostrofit, përgjithësimi i përdorimit të ë-s në bazë të formave të toskërishtes, shkrimi i fjalëve të huaja me c (revolucion, delegacion) e me l (filologji, logjikë), i fjalëve greke me dh e th (bibliotekë, aritmetikë, didaktikë), shumësi me j (ullij) etj.

Diskusimet qenë pozitive e dhënë material të vlershëm për përpunimin definitiv t'ortografisë. Në to pat vërejtje që lejojnë të ndreqen pasaktësi e të meta të projektit e të hartohet një ortografi sa më e saktë, e kurtë e praktike. Ato nxuarrën një seri problemesh që duhen studjuar më imtësisht për të pasur më shumë siguri në vendosjen e rregullave e më saktësi në formulimin e tyre.

Materiali i Konferencës dhe i vërejtjeve të tjera që pret Sekcioni i Gjuhësisë e Letërsisë nga arsimtarët, shkrimtarët e leronjësit e gjuhës do të ndihmojë mjaft punën e Komisionit të gjërë që do të formohet nga Instituti i Shkencavet me bashkëpunimin e Lidhjes së Shkrimtarëve dhe Ministrinë e Arësimit e Kulturës për t'i dhënë zgjidhje problemeve të kontestueshme t'ortografisë sonë.

M. Domi

ZBULIMET ARKEOLOGJIKE TË VITIT 1953

Muzeu Arkeologjik-Etnografik për vitin 1953 ka organizue ekspedita arkeologjike në dy krahina të randësishme për kulturën ilire: në luginën e mesme të lumit Mat dhe

në krahinën e Vlonës.

Ekspedita arkeologjike në luginën e lumit Mat vazhdoi studimin e tumulave, në zonën e hidrocentralit «Enver». Në fshatin Bush-

kash u hapën disa tumule të shekujve të tretë dhe të dytë para erës sonë. Tumulet e luginës së lumit Mat paraqiteshin interesante jo vetëm për objektet arkeologjike që kanë por edhe për konstrukcionin e tyre dhe për lidhjet me kulte të ilirve. Ekspedita arkeologjike zbuloi tumule të tjera të pa njoftun në fshatin Bazje, në luginën e lumit Mat dhe në qytetin e Burrelit. Bërmimet që do të bahen këtë vit do të ndihmojnë me njoftë ma mirë përdorimin e tumuleve dhe do të japin të dhana të reja mbi fisin ilir që banoi këtë krahinë, mbi jetën shoqërore dhe kultet fetare të këtij fisi.

Ekspedita arkeologjike në krahinën e Vlonës zhvilloi një punë ma të gjanë. Ajo bani kërkime dhe gërmime në shpellat e fshatit Velçë, në tumulet e fshatit Vajzë dhe në vendin e qytetit ilir Amantia, në fshatin Ploçë.

Në Velçë eksplorimi i një shpelle të njoftun si vendbanim i një komuniteti njerzish të kohës së fundit të neolitikut, fundit të mijvjeçarit të tretë dhe fillimit të mijvjeçarit të dytë para erës sonë, ka dhanë, në një thellësi deri m. 1.70 materiale arkeologjike të çmueshme: fragmente enësh prej balte të pjekun, keramike dhe armë e vegla prej guri. Disa pjesë enësh prej balte të pjekun kanë tregue lidhje me kultura fqinje dhe veçanërisht me kulturën e njoftun të Tripoljes (R.S.S. e Ukrainës)

Gërmimet në tumulet e fshatit Vajzë kanë dhanë materiale karakteristike të kohës së hekurit, kohës së Hallstatit (shekujt e nandë — dhe tetë erës sonë). Në varret e tumulit të hapun, në gërmimet e vitit 1953 janë zbulue, në shumicë armë prej bronxi, si maja shigjetash, maja heshtash, thika dhe një shpatë. Në një varr u gjet edhe një shpatë prej hekuri. Në varret e grave mbizotërojnë objektet e zbulurimit: gjylypana bronxi, sumbu-

lla bronxi dhe rruaza prej qelqi. Në një varr fëmijësh u gjet një rreth dore në trajtë spiraleje prej ari. Në varret nuk mungojshin enët prej balte me format e tyre elegante dhe karakteristike të kohës së hekurit.

Objektet e zbuluara në varret e tumulit të Vajzës janë zbulimet e para të këtij lloji që bahen në vendin tonë. Ato janë dokumente të randësishme të kulturës ilire të një perjudhe, për të cilin burimet historike heshtin. Njoftja si banues i kësaj krahine, në shekullin e katërtë para erës sonë, të fisit ilir të Amantëve, na shtyn të mendojmë dhe të pranojmë si bartës të kësaj kulture fisin ilir të Amantëve, në periudhën e dekompozimit të rendit fisor patriarkal.

Në fshatin Ploçë, në vendin e qytetit ilir Amantia, gërmimet vazhduen për nxjerrjen në dritë të një teatri antik. Në gërmimet e vitit 1953 u zbuluan krejtësisht shkallët e ndejes së teatrit, tue dalë në dritë kështu edhe forma e tij. Në këtë mënyrë rezultoi se teatri antik i Ploçës ka formën e një patkoni me brinjë të zgjatun deri në 50 metra, formë që ndryshon nga format e zakonshme të teatrove antike. Teatri i Ploçës asht teatri i dytë antik që zbulohet në vendin tonë, mbas atij të Butrintit. Teatri i Ploçës bije në sy edhe për madhësinë e tij; ai mund të merrte deri 4000-5000 vetë. Në gërmimet, në njenin krah u zbuluen në vend 17 radhë shkallësh, ndërsa në krahun tjetër kishin mbetë vetëm 7 radhë.

Teatri antik i Ploçës asht një tjetër provë e zhvillimit ekonomik e shoqnor skllavo-pronar që qyteti Amantia, qendër e ilirve Amante, kishte arritë në shekullin e tretë para erës sonë dhe një dokument i randësishëm i lidhjeve kulturele që ai kishte me botën greke të lashtë.—

S. Anamali

«KENGËT E SHQIPËRISË SË LIRË» *)

Muajt e fundit të kaluar në Moskë dolli në qarkullim një vëllim i ri me vjersha dhe poema të poetëve shqiptarë me titullin «Këngët e Shqipërisë së Lirë». Vëllimi i përkthyer nga D. Samojlllov, u botua nën kujdesin e shtëpisë botonjëse të letërsisë së huaj. D. Samojlllovi është i njohur edhe me përkthimin e vëllimit «Poema shqiptare» dhe të veprës së Çajupit.

Një fakt i tillë që zgjon me të vërtetë ndjenjën e gëzimit dhe të krenarisë në zemrat tona, tregon edhe njëherë kujdesin e madh, dashurinë dhe respektin që kanë njerëzit sovjetikë për artin tonë të ri të realizmit socialist, tregon vëmendjen e tyre për t'u njohur me sukseset tona në fushën e letërsisë së re. Kjo vëmendje e njerëzve sovjetikë duket dhe më kurtë në fjalët e shkrimtarit G. Gulia, i cili ka shkruar parathënien e këtij vëllimi: «Gjithnjë librin e njeriut të njohur e merr në duar me një interes të veçantë . . . » thotë ai duke përmendur faktin se ka pasur rastin të njihet personalisht me pjesën më të madhe të autorëve që janë përfaqësuar në vëllim. Sot në Bashkimin Sovjetik janë të panumurt ata që e marrin në duar me interes këtë libër, sepse ata ushqejnë një ndjenjë të madhe dashurie për popullin tonë të vogël, por heroik.

Kjo, sigurisht, kuptohet dhe më mirë nga fakti, se në vëllimin «Këngët e Shqipërisë së Lirë», janë paraqitur nga pjesët poetike më të bukura, të botuara mbas çlirimit. Një meritë tjetër e këtij vëllimi është dhe paraqitja e mirë e tematikës së poezisë sonë, duke marrë aspekte të ndryshme nga jeta në luftën nacional-çlirimtare dhe jeta për ndërtimin e bazave të socializmit. Pikërisht për këtë vëllim, siç theksohet dhe në parathënien e tij, do ta zgjerojë pa dyshim përfytyrimin e lexuesit sovjetik mbi krijimtarinë e poetëve të vendit tonë.

Në «Këngët e Shqipërisë së Lirë» kanë hyrë pjesë poetike si: poema e Aleks Çaçit «Me ty Stalin», poema e F. Gjatës «Kënga e partizanit Benko», poema e Andrea Varfit «Biri i Partisë», poema «Miku» e Ll. Siliqit, poema «Mbi krahn' e pruar të paqës» e Dh. Shuteriqit etj. Mund të thuhet pa hezitim, se më mirë nga të gjitha janë përkthyer poema «Kënga e Partizanit Benko» e F. Gjatës dhe poema «Miku» e Ll. Siliqit të cilat edhe në rusisht kanë fituar me të vërtetë bukuritë e tyre, forcën dhe muzikalitetin e vargut, figurat e mira poetike dhe emocionalitetin që kanë edhe në origjinal. Mjaft i mirë është edhe përkthimi i «Brigadjerës» së D. Siliqit, poemës «Me ty Stalin» të Aleks Çaçit, i «Birit të Partisë» të Andrea Varfit. Ndërsa në fragmentet e poemës «Herojt e Vigut» duket se përkthimi është më i dobët në krahasim me të gjithë pjesët e tjera; dhe ajo që e ul deri në një farë shkalle meritën e përkthimit është fakti se në të nuk ndihet bukuria dhe muzikaliteti, si dhe figurat shumë të bukura që ka në origjinal poema e K. Jakovës.

*) — Vëllim vjershash i përkthyer nga shqipja në rusisht — «Pjesni svobodnoj Albanii» Shtëpia Botonjëse e Letërsisë së Huaj Moskë — 1953

Por në tërësi duhet thënë se vëllimi ka dalë mjaft i mirë dhe përfaqësues për poezinë tonë të re. Është pikërisht kjo që na shtyn ne, si lexonjës, të falënderojmë përzemësisht poetin D. Samojlllov, i cili ka dhënë dhe po jep një kontribut mjaft të madh në përkthimin e poezisë sonë klasike dhe të re në rusisht.

B. Dedja

ROMANI «ÇLIRIMTARËT» I DH. SHUTERIQIT NË BULLGARISHT

Në tremujorin e fundit të vitit 1953, në Bullgari, dolli në qarkullim, i botuar nga shtëpia botonjëse «Kultura Popullore» — Sofje, dhe i përkthyer nga L. Grabocka dhe Th. Kacori, nën redaksinë e Dhimitër Angelovit, romani i Dhimitër Shuteriqit «Çlirimtarët». Përkthimi i romanit tonë të parë pas Çlirimit në gjuhën e popullit vëlla bullgar është një ngjarje e rëndësishme për letërsinë dhe kulturën tonë të re dhe një dëshmi e gjallë e miqësisë së thellë midis dy popujve tanë dhe e lidhjeve të reja kulturele midis dy vëndeve, që po ecin plot besim drejt ndërtimit me sukses të socializmit.

Me anë të romanit të Dhimitër Shuteriqit, lexonjësit bullgarë do të kenë përpara sysh një panoramë të gjendjes sonë shoqërore dhe politike gjatë viteve të parë të luftës së dytë botërore dhe, nëpërmjet hapave të ndryshme, edhe gjatë regjimit anti-popullor të bejlerëve të shitur, armiq të popullit dhe të kulturës së tij. Lexonjësi bullgar do të njihet me hapat e para të vështira por heroike të përhapjes së ideve përparimtare që përfunduan me krijimin e Partisë Komuniste Shqiptare, që ngriti lart flamurin e çlirimit nacional dhe i siguroi popullit më vonë jetën e lirë dhe të lumtur. Ai do njihet mirë me ambientin tipik shqiptar, me tokën tonë, me traditat tona, me disa zakone të cilat në një masë të gjërë kanë mjaft tipare të përbashkëta me ato të vetë bullgarëve.

Autorët e përkthimit i kanë qëndruar besnikë tekstit, janë munduar të ruajnë koloritin e stilit t'authorit dhe të gjejnë shprehjet përkatëse në gjuhën bullgare. Po duke qënë se të dy përkthyesit janë shqiptarë prej të kolonisë shqiptare të Sofjes dhe si të tillë — del kjo nga përkthimi — nuk e kanë atë thellësinë e duhur të njohjes së gjuhës që kanë folur dhe shkruar Botevi, Vazovi, Elin Pelini. Por, megjithatë, ndihet puna e redaksisë dhe leximi në përgjithësi është i këndshëm. Ka aty-këtu disa interpretime të gabuara të ndonjë figure të bukur të autorit, por, në tërësi, këto nuk peshojnë edhe shumë. Do të ishte e dëshërueshme që vetë përkthyesit të kishin marëdhënie shumë të ngushta me autorin e librit me korrespondencë të vazhdueshme për të sqaruar shprehje, fjalë figura të cilat për ta nuk kanë qenë të qarta.

Botimi i një romani shqiptar në bullgarisht duhet të nxisë edhe përkthyesit tanë që të kënaqin edhe kërkesën legjitime të popullit shqiptar për të parë sa më shpejt në vitrinat e librarive tona përkthimin e ndonjë romani bullgar midis atyre më të mirëve që e nderojnë letërsinë e ditëve të sotme të popullit vëlla bullgar, për ta njohur këtë edhe më afër, për të njohur më mirë Bullgarinë motër, me të cilën na lidh një miqësi e fortë dhe e sinqertë për sa të jetë jeta.

Z. Cikuli

LETËRSIJA JONË E RE NË MONGOLISHTË

Këto kohët e fundit ka ardhur në zyrat e Lidhjes së Shkrimtarëve kopja e një përmbledhjeje të poezisë e prozës sonë të re botuar në gjuhën mongole. Ajo është shtypur në Ulanbator, kryeqytet i Republikës popullore të Mongolisë, gjatë vitit 1953. Për të orientuar lexonjësën rreth tematikës që trajtohet ndër pjesët e përmbledhura dhe për t'ia bërë të njohur momentet dhe rrethanat historike që i kanë frymzuar, libri hapet me një hyrje të redaksisë e cila është kujdesur për përgatitjen e përmbledhjes.

Në libër gjejmë vjersha të ndryshme nga letërsia jonë e re, vjersha të A. Çaçit, Ll. Siliqit, L. Qafëzezit, V. Skënderit etj. si dhe poemën e F. Gjatës «Kënga e Partizanit Benko», që të gjitha të përkthyer nga poetë të ndryshëm mongolas. Përveç vjershave në përmbledhje janë përkthyer edhe dy proza: «Ky çuni i madh i Sal Cenit!» e Dh. S. Shuteriqit dhe «Medalja e trimërisë» e Zihni Sakos.

Përmbledhja ka për titull: «Letërsia e re e Shqipërisë» dhe paraqet në kopertinë, në formë medalioni, jetën e re që ka lindur në vendin tonë: oxhaqe fabrikash, traktorë që lërojnë dhe në sfond, një djell të madh që ka lindur mbi maja të larta malesh.

Ndonse nuk jemi në gjendje të shijojmë punën artistike të përkthimit, ne e çmojmë punën e shokëve mongolas si një tjetër kontribut të çmuar në forcimin e miqësisë ndërmjet popujve tanë, në ruajtjen e paqës, në njohjen e popullit tonë dhe të kulturës së tij jashtë kufijve të atdheut. Ne i falnderojmë me gjithë zemër shokët mongolas për kujdesin dhe dashurinë që tregojnë për popullin tonë dhe letërsinë e tij të re dhe urrejtjen që ky të jetë vetëm fillimi i një pune edhe më të frytshme e të koordinuar që të kontribuojë në njohjen sa më mirë të popujve tanë.

N. Uruçi

KULTURA NË BOTËN KAPITALISTE

TABELË PËRKUJTIMORE.

Në vënd-lindjen e Uiliam Shekspir, Stretford-avone, emrin e klasikut të madh anglez, për qëllime reklami, e shpërdorojnë pa asnjë farë skrupulli. Kështu, p. sh., gazeta daneze «Informashon», lajmëron se në rrugët e këtij qyteti mund të shikosh tabela, të cilat tregojnë rrugën për në... «garazhin e Shekspir»!

LETËRSI ME TABLETA.

Në libraritë amerikane blerësi, mbasi ka zgjedhur romanin dedektiv me titullin më sencacional, paguan të hollat në arkë dhe pastaj merr, përveç librit, edhe disa tableta qetësonjëse. Qëllimi i këtyre të fundit është që të ruajnë lexonjësën nga tronditjet nervoze që mund të ngjasin gjatë leximit. Sa më i tmerrshëm që të jetë «romani», lajmëron gazeta «Arbaitercaitung», aq më shumë tableta nevojiten. Kështu afaristat amerikanë vrasin dy zogj për njëherësh: njëkohësisht shesin fundërinat letrare dhe medikamentet e vjetra...

MUZIKË E «REZIKËSHME»

196 qendra informacioni të Amerikës, në 64 shtete, morën lista të zeza me titujt e atyre veprave muzikore, që mbahen si të «rezikëshme». Ndërmjet këtyre ndodhet sinfonia e kompozitorit amerikan Garis, me temë betejën e Stalingradit, si dhe oratoria e kompozitorit Koplend, kushtuar Avram Linkolnit. Për «fajin» e kompozitorëve të tjerë, të cilët përfshihen nëpër këto lista, dikasteri i Makartit nuk njofton gjë...

«VERTERI I RI».

Për lexonjësën angleze është botuar këto kohët e fundit një ndër librat e shumtë, në të cilat lavdërohet ushtërija hitleriane si edhe luftëtarët nacistë. Libri i ri që është popullarizuar gjerësisht nga botonjësit e Londrës, tregon autobiografinë e një ish piloti fashist – Heinc Knoke. Përkthimi në gjuhën anglisht mban titullin: «Unë kam fluturuar me urdhërin e Hitlerit». Knoke, ky armik i tërbuar i popujve të lirë, vizatohet nëpër reklama, si... hero!. Librin e tij, biznesmenët e ngrejnë në qiell, duke thënë se këtu «zbulohet patriotizmi i madh, disiplina e fortë dhe sentimentalizmi që i karakterizon gjermanët».

Të paraqesësh kriminelin fashist në pamjen e «Djaloshit Verter», a nuk është kjo një fyemje e rëndë për kujtesën e anglezve, që u vranë gjatë luftës së dytë botnore? ,...

MBROJTËSIT E «MAIN KAMFIT»

Në vitrinat e librarive të Gjermanisë perëndimore e shikon shpesh librin e Hitlerit «Main kamf». Në «atdheun» e Adenauerit, ka se kush kujdeset për shpërndarjen e kësaj «bible» të fashizmit. Tani Shtëpia botonjëse «Albert Djuhrer» në Braunshveige (zona angleze e pushtimit të Gjermanisë), lajmëron, sipas gazetës daneze «Land og Folk», qarkullimin e shpejtë dhe me tirazh të madh të kësaj veprë kaq të urreyer. Kështu, gradualisht, po zhduken ndryshimet e vogla në mes «Republikës së Bonit» dhe «Imperatorisë së tretë» të Hitlerit.

SHEKSPIRI I AMERIKANIZUAR.

Revista e përjavëshme demokratike gjermane «Zonitag» boton një seri karikaturash të cilat paraqesin «Shekspirin e amerikanizuar» Romeoja me kostum kovbojësh po grabit Xhiulietën nga pallati i saj. Nga pjesa «Një ëndër në natë vere», Fej dhe Elfa vallëzojnë në tingujt e saksofonit. Fantazma e babait, që i del përpara Hamletit, i flet kështu: «Në çoftë se nuk të flihet, pij koka-kola». Dhe ma së fundi Otelloja i ekzekutuar në mënyrën amerikane: «Ku-Klluks-Klanët varin arapin» . . .

NE VENDIN E SHTËPISË SË MOCARTIT.

Qyteti austriak Salzburg është atdheu i Mocartit. Në vitin 1944, shtëpia ku lindi kompozitori i madh u shkatërua nga një bombë amerikane. Kaluan 9 vjet, dhe ja më së fundi gjermadhat përpara shtëpisë u pastruan dhe filloi ndërtimi . . . Është e natyrëshme të mendosh se pushteti në fuqi vendosi të nimermetojë këtë monument të kulturës kombëtare. Por jo! Në vendin ku ngrihej shtëpia e Mocartit, tani po ndërtohet një ndërtesë tjetër. Dhe është interesante të dihet, se leja është dhënë . . . nga Ministrija e kulturës austriake.

VRASËSIT MORALË DHE FIZIKË.

22 vjeçari Zherar Dypre, nga Parisi, vitin e kaluar vrau prindërit e tij. Atë e gjykuan dhe e futën në burg. Porse u gjet një botonjë, i cili, siç lajmëron gazeta «Ymanite», menjëherë i propozoi vrasësit që të shkruante «memuare», duke i premtuar se do t'i paguante për këto 1 milion franga. A ka ndonje ndryshim nga Morali i Dypres edhe morali i botonjësit që bën tregti për helmatisjen e shpirtrave njerëzore? . . .

REKLAM ME GËTEN.

«Armik i duhanit, Gëtja ishte.—Po tjetër përshtypje do të kishte—sikur ai të blinte cigare «Fier» dhe t'i pinte. — Këto radhë poshtëruese në vargje, të bashkangjitura me portretin e Gëtes, zbukurojnë reklamën e cigareve amerikane «Fier», botuar në gazetën borgjeze zvicerane «Veltvohe». Biznesmenët dhe kapitalistët, në përpjekjet e tyre për të fituar sa më shumë para, kanë humbur çdo masë arsyetimi. . . Me cinizmin më të madh ata e paraqesin Xhiokondën duke pirë aperitiv, gostisin Hamletin me llastik përtpës. . . dhe detyrojnë Volterin të blejë «koka-kola. . .». Tani erdhi rradha e Gëtes. Ky reklam shërben për të treguar edhe një herë poshtërsinë dhe paturpësinë e shtypit borgjez se si «nderojnë» kujtimin e klasikëve të mëdhej dhe si e «vlerësojnë» veprën e tyre.

SURROGAT I RI LIBRASH.

«Poket buks» po ta përkthesh në shqipet do të thotë «libra xhepi» Po duhet shtuar, se nuk mjafton vetëm ky përkthim për të kuptuar si duhet këtë shpikje thjesht amerikane, me ndihmën e së cilës, deformohen dhe shëmtohen veprat e klasikëve të mëdhej.

Po «komiks» ç' do të thotë? «Komiks» edhe këto janë një surrogat librash që edukojnë injorancë.

«Poket buks» dhe «Komiks» janë shenja të dukshme që pasqyrojnë gjendjen katastrofale të letërsisë borgjeze në Amerikë . . .

«IDETË E MISTER MARKETIT».

Mister Marketi është profesor nga Bostoni. Pertej oqeanit atë e mbajnë si specialist të madh për reklamin. Ndoshta për këtë gjë mister Marketi e quan vehten e tij të denjë për t'i dhënë këshilla «inJORANTËVE» të Evropës perëndimore. Mbase dëgjoi se në Gjermaninë perëndimore teatrot nuk frekuentohen, misteri u alarmua. Është e vërtetë se banorët e «Republikës së Bonit» nuk zotërojnë para për t' u zbatimur. U mungojnë shumë gjëra, bile deri dhe ushqimi. Por kjo s' do të thotë gjë për mister Marketin. Mos frekuentimin ai e shpjegon vetëm me arsyen se këtu nuk dinë të bëjnë biznes. Sipas atij, për të fituar para kërkohen vetëm idera. Dhe ja, siç lajmëron revista gjermane «Noie Berliner Illustrirte» drejtorët e teatrove të Gjermanisë perëndimore morën letra nga Marketi. Sipas mendimeve të tij, ai rekomandon që të hiqen nga shfaqjet artistike titujt e veprave tashmë të vjetëruar dhe këto të zëvendësohen me «tituj të jetës së tanishme». Ja propozimet e tij:

TITULLI I VIJETËR

«Traviata»
«Vilhelm Teli»
«Vasha e Orleanit»
«Faust»
«Romeo e Xhulieta»
«Aida»

«Rigoletto»
«Karmen»
«Otello»
«Per Gynt»

TITULLI I RI

«Dashuria nuk vdes nga të kolliturit»
«Qitje në rrugicën e shkretuar»
«Zhana me uniformën ushtarake»
«Margërita dhe tregtari i shpirtrave»
«Rekordi botnor i dashurisë»
«Triumfi i dashurisë në hijen e piramidëve»
«Kufoma në thes»
«Dashnorja e Toreadorit»
«Hakmarrja e dorës së zezë»
«Per, ku je ti?»

Vepra letrare botuar gjatë vitit 1953

POEZI

- Skënder Arrëza** — «Këngët e Pranverës». Vjersha. Tirazhi 4000, Faqe 23. Çmimi lekë 7.50
- Mark Gurakuqi** — «Pranverë». Vjersha. — Tirazhi 4000, Faqe 72. Çmimi lekë 19.50.
- Kolë Jakova** — «Herojt e Vigut». Vjersha dhe poema. Faqe 50. Çmimi lekë 18.
- Luan Qafëzezi** — «Komunisti». — Poemë; — Tirazhi 3000. Faqe 61. Çmimi lekë 18.50.
- Llazar Siliqi** — «Vjersha dhe poema» — Tirazhi 4000. — Faqe 124. Çmimi 30 lekë.
- Vehbi Skënderi** — «Këngët e para». Vjersha. — Tirazhi 4000. Faqe 99. Çmimi lekë 30.
- Moisi Zaloshnja** — «Në zëmër të popullit.» — Poemë. Faqe 24. Çmimi lekë 8.
- «Mësuesit dhe Atit». Vjersha e proza të shkrimtarëve shqiptarë kushuar kujtimet të Stalinit. Faqe 141. — Çmimi lekë 38.

PROZË

- Zihni Sako** — «Ditë të gëzuara» — Novelë. — Tirazhi 4000. Faqe 120. Çmimi lekë 20.
- Dh. S. Shuteriqi** — «Pesë tregime» — Tirazhi 4000. Faqe 64. Çmimi lekë 12.
- Dh. S. Shuteriqi** — «Rruga e rinisë» — Tregime. Tirazhi 6000. Faqe 168. Çmimi lekë 25.
- Halim Stoliha** — «Për atdheun e lirë». Përmbledhje tregimesh. Faqe 140. Çmimi lekë 21.
- Reshat Nepravishta** — «Në një dorë kozmën, në tjetrën pushkën» — Novelë — Faqe 66, Çmimi lekë 15.

DRAMË

- Selman Vaqari** — «Zemra të ndezuna». — Tirazhi 5000. Faqe 40. Çmimi lekë 10.

LETËRSI PËR FËMIJË

- Aleks Çaçi** — «Na hoqën çatinë». — Tregim autobiografik. — Tirazhi 4000. Faqe 34. Çmimi lekë 11.50
- Fatmir Gjata** — «Zëmër shqiptare». Tregime. — Tirazhi 5000. Faqe 40. Çmimi lekë 10
- Luan Qafëzezi** — «Miku partizan». Vjersha. — Tirazhi 4000. Faqe 60. Çmimi lekë 17.
- Zihni Sako** — «Fëmijët tonë». — Vjersha — Tirazhi 4000. Faqe 16. Çmimi lekë 3
- Zihni Sako** — «Bardho Bardhoshi». — Tirazhi 6000. Faqe 55. Çmimi lekë 15.
- Zihni Sako** — «Ditët e para» — Tregime. Tirazhi 4000. — Faqe 30. Çmimi lekë 5.
- Selman Vaqari** — «Korrieri Pezës». Tregim. — Tirazhi 4000. Faqe 48.
- Selman Vaqari** — «Ceni. Cani Cini». Tregim. — Tirazhi 6000. Faqe 31. Çmimi lekë 7.50.
- Selman Vaqari** — «Guximtarët». — Tregime. — Tirazhi 4000. Faqe 48. — Çmimi lekë 11.

Kryeredaktor: Llazar Siliqi.

Kolegjiumi i redaksisë:

Kolë Jakova, Mustafa Krantja, Shevqet Musaraj, Luan Qafëzezi, Sterjo Spasse, Andrea Varfi, Nexhmedin Zajmi, Nesti Zoto,

Adresa e redaksisë: Tiranë, Rruga Ali Demi, Nr. 327, pranë Lidhjes së Shkrimtarëve të Shqipërisë, tel. 26-91.

PAJTIMËT; Për gjashtë muaj lekë 165, për një vit lekë 330

Ndermarrja Shtetnore Botimeve, Stabilimenti "Mihal Duri" Tiranë